

Strazbur

**KOMITETITI KËSHILLUES PËR KONVENTËN KORNIZË PËR MBROJTJEN E  
MINORITETEVE KOMBËTARE**

**Opinioni i dytë për “Ish Republikën jugosllave të Maqedonisë”  
miratuar në 23 shkurt 2007**

**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**

Që nga miratimi i Opinioneve të parë në maj të vitit 2004, autoritetet e “ish Republikës jugosllave të Maqedonisë” kanë bërë përpjekje të reja për përmirësimin e zbatimit të Konventës kornizë. Hapat e marra në nivelin legjislativ dhe institucional si pjesë e implementimit të Marrëveshjes së Ohrit paraqesin baza solide për rritjen e nivelit të mbrojtjes së personave që ju përkasin minoriteteve kombëtare.

Pjesëmarrja e personave që ju përkasin bashkësive të minoriteteve është rritur në mënyrë progresive. Sidomos komuniteti shqiptar luan një rol aktiv në jetën politike të vendit në nivel shtetëror dhe lokal. Përpjekje të rëndësishme janë bërë për zgjerimin e përdorimit të gjuhëve të minoriteteve në komunikim me dhe në autoritetet publike. Mundësitë për mësimin e gjuhës shqipe dhe për të pranuar udhëzime në këtë gjuhë janë zgjeruar. Progres është raportuar gjithashtu sa i përket qasjes në media të personave që ju përkasin bashkësive të minoriteteve.

Pavarësisht përpjekjeve për rritjen e respektin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë, dialogu ndëretnik mbetet i kufizuar dhe më tutje raportohen manifestime të diskriminimit ndaj personave që ju përkasin bashkësive të ndryshme etnike. Për t’u brengosur është rritja e ndarjes së fëmijëve dhe të rinjve që iu përkasin komuniteteve të ndryshme në arsim dhe aktivitete të lira.

Nevojat e komuniteteve të vogla meritojnë kujdes të madh. Përpjekje të vendosura janë të nevojshme në implementimin e Strategjisë nacionale për romët, për të adresuar vështirësitë dhe diskriminimet serioze me të cilat shumë romë ende ballafaqohen në aksesin e tyre në punësim, sigurim të banimit, kujdesin shëndetësor dhe arsim.

**TABELA E PËRMBATJES**

1. ZBULIME KRYESORE .....	4
Procedura e vëzhgimit .....	4
Shtrirja e zbatimit të Konventës .....	4
Korniza gjenerale legjislativë dhe institucionale.....	4
Lufta kundër diskriminimit.....	5
Toleranca dhe marrëdhëniet ndëretnike.....	5
Aksesi në media dhe prezenca në media.....	6
Përdorimi i gjuhëve të minoriteteve kombëtare në komunikim me autoritetet publike dhe nga autoritetet e tilla.....	6
Arsimi.....	6
Pjesëmarrja .....	7
Gjendja e romëve.....	7
II. ZBULIME NEN PAS NENI.....	8
Neni 3 i Konventës kornizë.....	8
Neni 4 i Konventës kornizë.....	10
Neni 5 i Konventës kornizë .....	14
Neni 6 i Konventës kornizë .....	16
Neni 7 i Konventës kornizë .....	19
Neni 8 i Konventës kornizë.....	20
Neni 9 i Konventës kornizë.....	20
Neni 10 i Konventës kornizë.....	23
Neni 11 i Konventës kornizë.....	24
Neni 12 i Konventës kornizë.....	26
Neni 13 i Konventës kornizë.....	31
Neni 14 i Konventës kornizë.....	32
Neni 15 i Konventës kornizë.....	33
Neni 16 i Konventës kornizë.....	37
Neni 18 i Konventës kornizë.....	37
III. VËREJTJE PËRFUNDIMTARE.....	39
Zhvillime positive.....	39
Çështje brengosëse.....	39
Rekomandime.....	40

## **KOMITETI KËSHILLUES PËR KONVENTËN KORNIZË PËR MBROJTJEN E MINORITETEVE KOMBËTARE**

### **OPINIONI I DYTË PËR “ISH REPUBLIKËN JUGOSLLAVE TË MAQEDONISË”**

1. Komiteti këshillues miratoi Opinionin e tanishëm në 23 shkurt të vitit 2007 në përputhje me nenin 26 (1) të Konventës kornizë dhe rregullës 23 të Rezolutës (97) 10 së Komitetit të ministrave. Zbulimet bazohen në informatat e përmbajtura në Raportin shtetëror (referuar më tutje si Raporti shtetëror), i pranuar në 16 qershor të vitit 2006, dhe burimet tjera të shkruara dhe në informatat e mbledhura nga Komiteti këshillues prej kontakteve qeveritare dhe joqeveritare të realizuara gjatë vizitës së tij në Shkup, Tetovë dhe Strugë prej 27 deri 29 nëntor të vitit 2006.
2. Pjesa nën I më poshtë përmban zbulimet kryesore të Komitetit këshillues për çështjet kryesore që kanë të bëjnë me implementimin e Konventës kornizë në “ish Republikën jugosllave të Maqedonisë”.
3. Të dy pjesët përbëjnë një referenë të zgjeruar të përfundimit të dhënë në zbulimet nga cikli i parë i vëzhgimit të Konventës kornizë, të përmbajtur në Opinionin e parë të Komitetit këshillues për “ish Republikën jugosllave të Maqedonisë” i cili u miratua në 27 maj të vitit 2004 dhe në Rezolutën përkatëse të Komitetit të ministrave miratuar në 15 qershor të vitit 2005.
4. Vërejtjet përfundimtare të përmbajtura në Pjesën III mund të shërbejnë si baza për konkluzat dhe rekomandimet e ardhshme të Komitetit të ministrave për “ish Republikën jugosllave të Maqedonisë”.
5. Komiteti këshillues pret me padurim të vazhdoj dialogun me autoritetet e “ish Republikën jugosllave të Maqedonisë” si dhe me përfaqësuesit e minoriteteve kombëtare dhe të tjerë të involvuar në implementimin e Konventës kornizë. Me qëllim të promovimit të një procesi gjithpërfshirës dhe transparent, Komiteti këshillues inkurajon shumë autoritet që Opinionin e tanishëm pas pranimit të tij t’u bëjë publik.

## **I. ZBULIME KRYESORE**

### **Procedura e vëzhgimit**

6. “Ish Republika jugosllave e Maqedonisë” ka miratuar një qasje konstruktive drejt procesit të vëzhgimit të Konventës kornizë. Autoritetet zgjodhën një publikim të hershëm të Opinionit të Komitetit këshillues dhe në tetor të vitit 2005, mbajtën një seminar që pason menjëherë pas publikimit, për të diskutuar bashkë me përfaqësuesit e minoriteteve kombëtare dhe të Komitetit këshillues konkluzat e ciklit të parë të vëzhgimit.
7. Komiteti këshillues përshëndet vullnetin e autoriteteve për të vazhduar dialogun e tyre në implementimin e Konventës kornizë në kontekst të ciklit të dytë të vëzhgimit. Megjithatë, edhe pse Raporti i dytë shtetëror përmban përshkrim detal të zhvillimeve legjislativë dhe politike në fushën e mbrojtjes të minoriteteve, vërehet se raporti jep informata të kufizuara për ndikimin e këtyre masave në gjendje aktuale të personave dhe komuniteteve në fjalë. Në këtë drejtim, do të ishte e dobishme të bëheshin

konsultime më të gjëra dhe efektive me shoqërinë civile në përgatitjen e Raportit shtetëror. Komiteti këshillues me kënaqësi vëren se Konventa kornizë dhe mekanizmat e tij të vëzhgimit janë të njohura për organizatat e minoriteteve dhe OJQtë për të drejtat e njeriut, duke përfshirë këtu edhe OJQtë e romëve, të cilat në mënyrë aktive janë involvuar në aktivitete të ndryshme për ngritjen e vetëdijes për Konventën kornizë, që janë organizuar në vend vitet e fundit.

### **Gjerësia e zbatimit të Konventës kornizë**

8. Komiteti këshillues është i kënaqur të vërej që “Ish Republika jugosllave e Maqedonisë” formalisht ka zgjeruar gjerësinë e zbatimit të Konventës kornizë edhe tek boshnjakët dhe që deklaratës së depozituar pas ratifikimit i janë bërë amendamente në përputhje. Në të njejtën kohë, Komiteti këshillues ndjen keqardhje që deklaratata e reviduar për dallim nga origjinali ka kufizuar shtrirjen e Konventës te shtetasit.

9. Autoritetet duhet të vazhdojnë më tutje dialogun e tyre me egjiptianët të cilët tradicionalisht jetojnë në vend me masat për perkrashjen e ruajtjes së zhvillimit, identitetit dhe kulturës së tyre. Gjithashtu, autoritetet mund të marrin në konsideratë, në konsultim me ata që janë potencialisht të interesuar, mundësinë për përfshirjen e personave që ju përkasin grupeve të tjera, ku është e duhur të përfshihen edhe jo shtetasit, në zbatimin nën pas neni të Konventës kornizë.

### **Legjislativa e përgjithshme dhe korniza institucionale**

10. Nga cikli i parë i vëzhgimit të Konventës kornizë, “ish Republika jugosllave e Maqedonisë” ka bërë përpjekje për zhvillim e mëtutjeshëm të kornizës legjislative dhe institucionale të saj, e cila ka të bëjë me implementimin e Konventës kornizë. Hapa pozitiv përmban miratimi i fundit i ligjit për barazi mes grave dhe burrave dhe diskutohet për nisma të tjera siç janë miratimi i mundshëm i ligjit të ri për gjuhët dhe ligj i ri për religjionin. Me rëndësi është që minoritetet kombëtare të konsultohen dhe të merren parasysh brengosjet e tyre ashtu siç duhet, në procesin e rëndësishëm legjislativ.

11. Shumica e zhvillimeve të vërejtura në nivel legjislativ dhe institucional rrjedhin nga Marrëveshja paqësore kornizë e Ohrit<sup>1</sup>, që së bashku me ndryshimet kushtetuese të miratuara që nga viti 2001, paraqesin bazë solide për ngritjen e nivelit të mbrojtjes së personave që ju përkasin minoriteteve kombëtare në “ish Republikën jugosllave të Maqedonisë”. Sidoqoft, me rëndësi është që në të gjithë fushat e rëndësishme, autoritetet sigurojnë se në përputhje me Konventën kornizë kujdes i nevojshëm i kushtohet gjendjes dhe nevojave reale të gjithë bashkësive duke përfshirë edhe ata të vogla. Kjo ka rëndësi të madhe pasi bashkësitë e vogla në përgjithësi nuk plotësojnë 20% e nevojshëm për të fituar masat e veçanta për mbrojtje, në fusha siç janë arsimit apo përdorimi i gjuhëve të tjera nga gjuha maqedone.

12. Një zhvillim tjetër i rëndësishëm është implementimi i papërfunduar i procesit të decentralizimit, bazuar në Ligjin e decentralizimit nga viti 2002 dhe ndryshimeve pasuese legjislative. Komiteti këshillues vëren edhe pse decentralizimi duhet të ndihmojë në përforcimin e pjesëmarrjes efektive dhe mbrojtjes së minoriteteve kombëtare në sektoret kryesore, siç janë arsimit, kultura dhe shëndetësia, implementimi në praksë i këtij procesi sot mbetet një sfidë e rëndësishme për autoritetet, si për ata të nivelit qendror ashtu edhe për ata të nivelit lokal.

### **Lufta kundër diskriminimit**

13. "Ish Republika jugoslave e Maqedonisë" ka vazhduar me përpjekjet në luftën kundër diskriminimit dhe në përmirësimin e vetëdijes publike për këtë fenomen, sidomos nëpërmjet aktiviteteve të Avokatit të popullit dhe zyrave territoriale të tij. Në këtë drejtim, Komiteti këshillues vëren që janë ndërmarrë masa të rëndësishme për përsheptimin e implementimit të parimit për përfaqësim të barabartë të bashkësive etnike, në përputhje me kërkesat nga Marrëveshja e Ohrit.

14. Megjithatë, të metat mbeten, përfshirë edhe nivelin legjislativ ku duhet të miratohet legjislativë gjithëpërfshirëse në luftën kundër diskriminimit. Edhe pse shumë pak raste janë drejtuar në gjykata, raportet tregojnë se manifestime të intolerancës dhe diskriminimit mbeten problem. Këto janë të shprehura sidomos te romët, por edhe te personat që ju përkasin minoriteteve tjera kombëtare, në fusha siç janë mundësia për hyrje në punësim, në sigurimin e banesës, shëndetësi, arsim, dhe shërbime publike. Gjendja e grave që ju përkasin grupeve të ndryshme meriton një kujdes të veçantë.

### **Toleranca dhe marrëdhëniet ndëretnike**

15. Edhe pse janë ndërmarrë hapa për rritjen e respektit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë mes gjithë personave që jetojnë në "ish Republikën jugosllave të Maqedonisë", komunikimi dhe bashkëveprimi mes shqiptarëve dhe maqedonasve mbetet i kufizuar. Komiteti këshillues është posaçërisht i brengosur që barrierat etnike vazhdojnë të vështirësojnë dialogun ndërkulturor mes fëmijëve që ju përkasin bashkësive të ndryshme etnike në arsim dhe në jetën e përditshme të tyre. Mangësi janë raportuar gjithashtu edhe sa i përket kontributit të mediave në përkrahjen e tolerances dhe komunikimit mes grupeve të ndryshme.

16. Inkurajuese janë nismat e ndërmarra, shpesh nga anëtarët e shoqërisë civile që kanë për qëllim të përmirësojnë këtë gjendje. Hapa pozitiv janë ndërmarrë në adresimin e mangësive në trajtimin e personave që ju përkasin minoriteteve kombëtare nga ana e policisë.

17. Gjendja e romëve, ashkalinjeve dhe egjiptianëve të cilët janë aratisur nga Kosova është shqetësuese, disa prej të cilëve janë ndeshur me zbrapsje të armatosur.

### **Mundësia për qasje në media dhe prezenca në media**

18. Hapa pozitive janë ndërmarrë për përmirësimin e aksesit në radio publike dhe programe televizive për personat që ju përkasin bashkësive të ndryshme etnike dhe për të siguruar pjesëmarrjen e tyre në bordet e mediave publike. Gjithashtu, përmirësime janë bërë edhe në nivelin rregullues, duke përfshirë relacionin e aksesit të minoriteteve me mediat private. Përpjekje të zmadhuara janë të nevojshme për t'a zgjeruar aksesin e personave që ju përkasin bashkësive që sipas numrit janë më të vogla në media, sidomos në nivelin lokal dhe për të përmirësuar imazhin e minoriteteve që i përçohet publikut.

19. Ashtu siç theksohet në raportet e ndryshme, sidomos shqetësuese është ajo që mediat në "ish Republikën jugosllave të Maqedonisë" vazhdojnë të jenë të ndara sipas linjës etnike.

## **Përdorimi i gjuhëve të minoriteteve kombëtare në komunikim me autoritetet publike dhe nga ana e këtyre autoriteteve**

20. Sa i përket përdorimit të gjuhëve të minoriteteve për emrat personal, për dokumentet personale dhe shenjave topografike janë bërë disa zhvillime pozitive në legjislativë dhe në praktikë, edhe pse mangësitë ngelin, përfshirë këtu edhe mungesën e vullnetit politik. Progres është vërejtur në përdorimin e këtyre gjuhëve në komunikim me autoritetet publike dhe në autoritetet publike në nivel lokal dhe qendror. Kjo kryesisht i përket gjuhës shqipe, e cila sipas Marrëveshjes së Ohrit mund të përdoret si gjuhë zyrtare në nivel shtetëror dhe në nivel të komunave ku flitet nga së paku 20% e popullatës.

21. Më pak informata ka për përdorimin praktik, në shenjat topografike dhe në kontakte me administratën lokale, të gjuhëve që fliten nga bashkësitë që sipas numrit të tyre janë më të vogla, siç janë turqit, romët dhe serbët, në ato komuna ku plotësohen kushtet ligjore. Në lidhje me këtë dhe të tjera, Komiteti këshillues mendon se diskutime të vazdueshme janë shumë të rëndësishme për miratimin e mundshëm të një ligji për përdorimin e gjuhëve.

### **Arsimi**

22. Edhe pse ende raportohen mangësi, hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë për zgjerimin e të mësuarit të gjuhës shqipe dhe të mësuarit në gjuhën shqipe, duke përfshirë edhe nivelin universitar. Gjithashtu, janë nisur iniciativa për të rritur mundësitë për serbët, turqit dhe boshnjakët të studiojnë në gjuhët e tyre, edhe pse në këtë drejtim janë të nevojshme më shumë rezultate konkrete. Një varg masash specifike janë miratuar pre përmirësimin e gjendjes së romëve në arsim.

23. Sidoqoftë është shqetësuese, duket se disponueshmëria e arsimit në gjuhën e nënës për bashkësitë më të vogla etnike mbetet e kufizuar. Në përgjithësi, përgatitja për arsim të personave që iu përkasin minoriteteve dhe të ngjajshmëve me shumicën është e ndikuar nga vështirësitë që rezultojnë nga procesi i implementimit të procesit të decentralizimit dhe mungesës së resurseve. Kontakte të kufizuara mes studentëve dhe mësimitdhënësve nga komunitetet e ndryshme (sidomos maqedonasit dhe shqiptarët) paraqesin çështje serioze brengosëse që kërkon veprim të vendosur nga Qeveria. Përveç kësaj, shkollat fillore private ende nuk janë të lejuara me legjislacionin e vendit.

### **Pjesëmarrja**

24. Për shkak të implementimit gradual të parimit të përfaqësimit të barabartë i mbajtur në Marrëveshjen e Ohrit dhe Kushtetutën e ndryshuar, pjesëmarrja e personave që iu përkasin bashkësive etnike në më shumë institucione publike është rritur në mënyrë progresive. Veçanërisht shqiptarët luajn rol aktiv në skenën politike, edhe në qeveri edhe në opozitë.

25. Mangësi mbeten në përfaqësimin e bashkësive të ndryshme në strukturat që zbatojnë ligjin si dhe në ato gjyqësore, që veçanërisht dëmtojnë komunitetet që sipas numërit janë më të vogla. Gjithashtu, edhe pse janë vendosur komitete këshilluese për marrëdhënie ndëretnike në më shumë komuna, efekti i këtyre trupave të ri mbetet i kufizuar. Vështirësi janë raportuar në pjesëmarrje e personave që i përkasin shumicës në fusha ku këta persona janë *de facto* në pozitë minoriteti.

## **Gjendja e romëve**

26. Pavarësisht përpjekjeve të bëra nga autoritetet për përmirësimin e gjendjes së romëve në varg fushash, shumë nga romët ballafaqohen me diskriminimin dhe përjashtimin social, me problem serioze të vërejtura në fushën e punësimit, sigurimit të banimit, dokumenteve personale, shëndetësisë dhe arsimit. Përpjekje më të vendosura janë të duhura për të siguruar implementim e plotë dhe efektiv të Strategjisë nacionale për romët dhe Planin aksionar nacional përkatës.

27. Edhe pse masa positive janë ndërmarrë për të përmirësuar relacionet mes romëve dhe policisë, ende raportohen incidente për abuzime nga policët ndaj romëve. Masat specifike të nisura për parandalimin dhe adresimin e këtyre problemeve duhet të përforcohen. Përpjekje të përbashkëta janë të nevojshme për rritjen e pjesëmarrjes së romëve në jetën publike.

## **II. ZBULIME NEN – PAS – NENI**

### **Neni 3 i Konventës kornizë**

#### **Shtrirja personale e zbatimit të Konventës kornizë**

##### *Zbulime nga cikli i parë*

28. Në Opinionin e tij të parë, Komiteti këshillues përshëndeti drejtimin e autoriteteve nga një qasje më fleksibile sa i përket shtrirjes personale të zbatimit të Konventës kornizë dhe mendon se duhet të merret parasysh përfshirja e personave që u përkasin grupeve tjera, përfshirë në mënyre të përshatshme edhe joshtetasit, në shtrirjen e Konventës kornizë në baza nen-pas-neni.

29. Komiteti këshillues ka vërejtur se egjiptianët kanë qenë të pakënaqur nga refuzimi i autoriteteve të pranojnë identitetin e ndarë të tyre dhe dëshiruan të përfitojnë nga mbrojtja e Konventës kornizë. Autoritetet ishin të inkurajuar të sigurojnë se identiteti i këtyre personave është i respektuar dhe të ekzaminojnë mundësinë për përfshirjen e këtij grupi në shtrirje personale të Konventës kornizë.

##### *Gjendja e tanishme*

###### a) Zhvillime pozitive

30. Komiteti këshillues me kënaqësi vëren se në “ish Republikën jugosllave të Maqedonisë” është zgjeruar shtrirja personale e zbatimit të Konventës kornizë përtej grupeve të numëruara në deklaratën fillestare të bërë nga autoritetet maqedonase pas ratifikimit të Konventës kornizë, me përfshirjen e personave që i përkasin minoritetit boshnjak. Sipas deklaratës së korigjuar që i është dërguar Këshillit të Europës në qershor të vitit 2004, “termi “minoritete kombëtare” i përdorur në Konventën kornizë dhe dispozitat e të njejtës Konventë do të aplikohen në qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët jetojnë brenda kufijve të saj dhe të cilët janë pjesë e popullit shqiptarë, popullit turk, popullit vllah, popullit serb, popullit romë dhe popullit boshnjak.”

31. Komiteti këshillues vërejt me interes diskutimet që tani janë në zhvillim, brenda vendit dhe në bashkëpunimin bilateral në lidhje me pyetjen për përfshirjen e kroatëve në

masat mbrojtëse për minoritetet kombëtare pas kërkesës së bërë nga ana e tyre. Përshëndet qasjen e hapur të autoriteteve dhe nxit ato të vazhdojnë këto diskutime në konsultim me ato që kanë interes.

b) Cështje të diskutueshme

32. Gjatë dialogut me Komitetin këshillues, Egjiptianët<sup>ii</sup> kanë pohuar përsëri dëshirën e tyre për të pranuar mjete financiare nga shteti për të ruajtur kulturën e tyre dhe për të patur mundësi për të marrur pjesë efektive në punët publike. Sipas autoriteteve, vec më ka filluar dialogu me përfaqësuesit e tyre edhe pse diskutimet në të vërtetë nuk kanë përparuar sa u përket pritjeve specifike të komunitetit dhe si pasojë e kësaj përparim konkret nuk është raportuar sa i përket kësaj pike. Komiteti këshillues vëren se këto persona konsiderohen nga autoritetet dhe nga shumica e popullsisë të jenë romë prandaj nuk përbëjnë grup të ndarë etnik. Përvec kësaj, duket se sjellja e shoqërisë ndaj tyre ka sjellur deri te marginalizimi i tyre që përvec faktorëve tjerë ka ndikuar në vetë perceptimin e tyre.

33. Komiteti këshillues me keqëardhje vëren se përderisa deklarata e korigjuar e Qeverisë zgjeron shtrirjen e Konventës kornizë edhe në boshnjakët, në të njejtën kohë e ka kufizuar në personat që kanë shtetësinë e “ish Republikës jugosllave të Maqedonisë”. Një hap i tillë shkon kundër përpjekjeve për të zhvilluar një qasje më të nuancuar të përdorimit të shtetësisë si kriter në mbrojtjen e minoriteteve.<sup>iii</sup>

*Rekomandime*

34. Komiteti këshillues nxit autoritetet të vazhdojnë të kenë qasje fleksibile dhe dinamike në shtrirjen e zbatimit të Konventës kornizë. Inkurajon ato ekzaminojnë përfshirjen e mundshme në shtrirjen e Konventës kornizë të personave që u takojn grupeve tjera që kanë shfaqur interes në mbrojtjen që ofron kjo Konventë. Kjo duhet përfshirë përshtatshmërisht jo shtetasit në baza nen pas neni. Në lidhje me këtë, autoritetet duhet të rishqyrtojnë vendimin e tyre të fundit për paraqitjen e shtetësisë si kriter në deklaratë.

35. Sidomos, autoritetet duhet të vazhdojnë dialogun e tyre me egjiptianët me qëllim të rishqyrtimit të masave të duhura për të ruajtur identitetin e tyre dhe të mundësuar pjesëmarrjen e tyre në punët publike.

**Mbledhja e të dhënave**

*Zbulime nga cikli i parë*

36. Në Opinionin e parë, Komiteti këshillues ka nënvizuar rëndësinë për të patur të dhëna përgjegjëse për përbërjen etnike të popullsisë dhe ka vërejtur se sidomos personat që iu përkasin minoriteteve kanë kundërshtuar rezultatet e regjistrimit të popullatës. Për këtë, Komiteti këshillues ka inkurajuar autoritetet të merr parasysh plotësimin e kësaj informate me anketa tjera statistikore, duke patur parasysh parimet e përmbajtura në Rekomandimet e Komitetit të ministrave Nr. (97) 18 në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale të mbledhura dhe përpunuara për arsye statistikore.

*Gjendja e tanishme*

a) Zhvillime positive



37. Komiteti këshillues vëren se autoritetet përpunojnë të dhëna të ndryshme, të cilat dallohen sipas kriterëve siç janë mosha, gjinia, shpërndarja gjeografike etj., për numrin dhe gjendjen e personave që iu përkasin komuniteteve etnike në sektoret e ndryshme dhe për të mbledhur të dhëna të tilla studime sociologjike dhe anketa janë bërë në baza periodike.

b) Çështje të diskutueshme

38. Komiteti këshillues vëren se ende ka pikëpamje të kundërta për rezultatat e regjistrimit të popullatës. Komiteti këshillues mendon se këto rezultate duhet të kontrollohen në lidhje me informatat e azhuruara të cilat janë siguruar nga anketat më të fundit demografike dhe sociologjike, me qëllim që të sigurohet implementim më pragmatik dhe fleksibil i politikave për minoritetet në sektore të ndryshme.

39. Komiteti këshillues gjithashtu vëren se në kontekst të masave të ndërmarra për implementimin e parimit për përfaqësimin e drejtë, autoritetet kompetente gjerësisht i përdorin të dhënat për prejardhjen etnike të individëve, të cilat mbledhen rregullisht dhe janë publike. Në këtë kontekst, Komiteti këshillues mendon se është me rëndësi që autoritetet sigurojnë natyrën fakultative të çdo pyetje që ka të bëjë me prejardhjen etnike të një personi dhe që mbledhja dhe përpunimi i të dhënave janë në përputhshmëri me normat ndërkombëtare që rregullojnë përdorimin dhe mbrojtjen e të dhënave private.

#### *Rekomandim*

40. Autoritetet që kanë për detyrë të mbledhin dhe përpunojnë të dhënat lidhur me prejardhjen etnike duhet të kushtojnë vëmendje të duhur të drejtës së çdo personi që u përket minoriteteve kombëtare “lirisht të zgjedh të trajtohet apo jo si i tillë”, kjo është e përmbajtur në nenin 3 të Konventës kornizë, si dhe në parimet e përmbajtura në Rekomandimin e Komitetit të ministrave (97) 18 që ka të bëjë me mbrojtjen e të dhënave personale të mbledhura dhe përpunuara për qëllime statistikore. Kur planifikohen politika dhe shpërndahen resurse, të dhënat e regjistruara për përbërjen etnike të popullatës duhet shoqëruar nga informata plotësuese të siguruar nga anketat e fundit demografike dhe sociologjike.

### **Neni 4 i Konventës kornizë**

#### **Korniza legale dhe institucionale për luftën kundër diskriminimit**

Zbulime nga cikli i parë

41. Në Opinionin e parë, Komiteti këshillues konstatoi mangësi në kornizën legale që ofron mbrojtje nga diskriminimi dhe nxiti autoritetet të zgjerojnë shtrirjen e dispozitave ligjore për mos diskriminimin. Përveç kësaj, autoritetet ishin të nxitura t'i përshpejtojnë përpjekjet e tyre në sigurimin e njohjes dhe përkrahjes adekuate të punës së Avokatit të popullit.

#### *Gjendja e tanishme*

a) Zhvillime pozitive

42. Komiteti këshillues përshëndet faktin që tani Avokati i popullit është një figurë e përforcuar në peisazhin institucional të vendit dhe se janë dhënë informata dhe janë organizuar fushata për vetëdije, duke përfshirë edhe ato të organizuara nga zyrat lokale të Avokatit të popullit, me qëllim të njoftimit të publikut dhe shërbimeve civile me këtë institucion. Më tutje, vëren se materiali për informim dhe vetëdije është shpërndarë në gjuhët e minoriteteve kombëtare dhe këto gjuhë mund të përdoren kur aplikohet te Avokati i popullit.

43. Komiteti këshillues vëren se Avokati i popullit *inter alia* (ndër të tjera) ka për detyrë të vëzhgoj implementimin e parimit të mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë të komuniteteve etnike në organet publike, si dhe zbatimin e Ligjit për barazi gjinore që nga hyrja në fuqi në vitin 2006. Sidoqoftë, sipas informatave të dhëna nga Zyra e Avokatit të popullit, Avokati i popullit ka pranuar shumë pak ankesa për diskriminim etnik nga persona që iu takojn minoriteteve kombëtare.

b) Çështje të diskutueshme

44. Komiteti këshillues ka marrë shënime për pikëpamjet e ndryshme të shprehura gjatë vizitës së tij në “ish Republikën jugosllave të Maqedonisë” lidhur me nevojën për një ligj të posaçëm për antidiskriminim, për të cilin përfaqësuesit e disa organeve shtetërore mendojnë se nuk është i nevojshëm. Megjithatë Komiteti ka vërejtur, edhe pse neni 9 i Kushtetutës parashikon mbrojtje gjenerale nga diskriminimi, legjislacioni ekzistues nuk parasheh ndëshkime të veçanta për shkelje.

45. Ngjajshëm, sic është deklaruar nga burime të ndryshme<sup>iv</sup>, fushat e banimit, kujdesit shëndetësor dhe aksesit në shërbimet publike nuk janë mbuluar me legjislacion të posaçëm për antidiskriminim dhe dispozitat ekzistuese për antidiskriminim shpesh janë të paqarta, deshtojn të saktësojnë pasojat në rast dhune, rralle përdoren në gjykata, dhe disa nga ato rregullojnë kërkesa e panevojshme shtetësie. Gjithashtu është përmendur se neni 319 i Kodit penal i cili inkriminon nxitjen e urrejtjes, mosmarreveshjes dhe intolerancës kombëtare dhe religjioze (sidoqoftë, pa dhënë një mbrojtje të veçantë nga diskriminimi racor apo etnik) përdoret shpesh rralle ose fare nuk përdoret nga gjykatat.

46. Kjo situatë, sipas burimeve joqeveritare si dhe sipas një numri të vogël ankesash për diskriminim të bëra te Avokati i popullit, reflekton mungesën e besimit të publikut në institucionet ekzistuese për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshirë edhe Avokatin e popullit si institucion, si dhe në ilaçet juridike të disponueshme. Sidoqoftë, Komiteti këshillues vëren se vazhdon të raportohen raste të diskriminimit ndaj personave që u përkasin minoriteteve kombëtare sidomos ndaj romëve, shqiptarëve dhe turqve.

47. Me rëndësi është të sigurohet se fushata për ngritjen e vetëdijes ka prekur të gjithë paditësit potencial dhe se publiku është mjaft i njoftuar me parimin e mosdiskriminimit dhe me standardet e rëndësishme juridike. Përderisa përshëndeten përpjekjet e bëra në këtë fushë, Komiteti këshillues vëren se ato shpesh janë të zbatuara nga OJQ-të, të cilat kanë kapacitete dhe resurse të kufizuara dhe shpesh punojnë në bazë të projekteve të varura nga përkrahja financiare ndërkombëtare.

*Rekomandime*

48. Autoritetet duhet të ekzaminonj dispozitat ekzistuese për antidsikriminim dhe të ndër marrin hapat e duhura legjislative, dhe sipas nevojës të miratohet legjislacion gjithëpërfshirës antidiskriminues. Kjo ka për qëllim të siguroj se legjislacioni i vendit përmban mbrojtësa të përshtatshëm nga diskriminimi etnik në të gjithë fushat dhe se përmban kompensime për efektive të disponueshme për viktimat potenciale.

49. Përpjekje më të vendosura duhet bërë për të rritur vetëdijen e publikut për të drejtat e njeriut dhe për aksionin për të luftuar diskriminimin, si dhe për të involvuar dhe përkrahur OJQ-të aktive në këtë fushë me qëllim që të rrisin kapacitetet e tyre. Puna e Avokatit të popullit në këtë drejtim duhet përkrahur edhe më tutje. Gjithashtu janë të nevojshme masa të përshtatshme për mbledhjen e informatave të azhurnuara për raste të diskriminimit ndaj personave që u përkasin minoriteteve kombëtare, si dhe për luftimin dhe dënimin e manifestimeve të tilla.

**Barazi e plotë dhe efektive. Gjendja e romëve***Zbulime nga cikli i parë*

50. Në Opinionin e tij të parë, Komiteti këshillues ka vërejtur praktika diskriminuese ndaj romëve në më shumë fusha dhe ju ka bërë thirrje autoriteteve të ndër marrin hapat e duhura për të sanuar këtë gjendje. Më tutje ka ftuar autoritetet të paraqesin një strategji nacionale për romët me financa adekuate, me qëllim të zvoglimit të dallimit socio-ekonomik mes romëve dhe pjesës tjetër të popullatës.

51. Gjithashtu, Komiteti këshillues ka shënuar problemet me të cilat ballafaqohen disa persona që u përkasin minoriteteve, sidomos shqiptarët dhe romët, në marrjen e shtetësisë së vendit, me pasoja të pafavorshme sa i përket aksesit në të drejtat sociale, politike dhe ekonomike. Autoritetet janë ftuar të përkushtojn kujdesin e duhur problemeve me të cilat ballafaqohen këto persona në procesin e naturalizimit.

*Gjendja e tanishme*

## a) Zhvillime pozitive

52. Komiteti këshillues me kënaqësi vëren se që nga Opinioni i tij i parë është hartuar një Strategji nacionale për romët në bashkëpunim me këto të fundit dhe pasi ka kaluar debatin e hapur publik është miratuar nga Qeveria në janar të vitit 2005. Në të njejtën kohë, është miratuar Plan nacional për veprim për të implementuar këtë strategji në katër fusha: punësimin, banimin, arsimin dhe shëndetësinë. Aktivitete për rritjen e vetëdijes janë organizuar për të inkurajuar autoritetet relevante lokale për të miratuar plane lokale për veprim në punën e tyre dhe të ndajnë fonde speciale në buxhetet lokale për këtë qëllim. Gjithashtu është bërë një dispozitë sipas së cilës këto fonde mund të plotësohen në bazë të projekteve të cilët sipas sektorit dorëzohen në ministrinë përkatëse. Për më shumë, autoritetet janë aktivisht të involvuara në Dekadën për përfshirjen e romëve (2005-2015), e cila paraqet një nismë të vendosur nga tetë shtete të Europës qendrore dhe juglindore, dhe ka për qëllim të siguroj një kornizë për veprim të qeverive për të përshpejtuar përfshirjen sociale dhe për të përmirësuar gjendjen ekonomike dhe sociale të romëve në gjithë regjionin.

53. Sipas përfaqësuesve të Ministrisë së punës dhe politikës sociale, vlerësimi i implementimit të strategjisë dhe planit nacional për veprim në vitin e parë (2006) ka treguar rezultate inkurajuese, sidomos në fushën e arsimit dhe punësimit. Sa i përket punësimit, janë paraparë masa aktive për të ndihmuar romët në fitimin e kualifikimeve si dhe një nxitje për të dhënë informata dhe trajnim për fillimin e bizneseve të vogla familjare, sëbashku me përpjekjet për të inkurajuar punëdhënësit të angazhojnë romët. Gjithashtu, masa të ndryshme janë ndërmarrë për të lehtësuar qasjen e romëve në të drejtat shëndetësore dhe sociale (për më shumë hollësi shih Raportin shtetëror).

b) Cështje të diskutueshme

54. Përderisa përshëndet përpjekjet e Qeverisë në disa vite të fundit, Komiteti këshillues ende është i brengosur për dallimin e qëndrueshëm mes romëve dhe pjesës tjetër të popullatës dhe problemet me të cilat ato ballafaqohen çdo ditë. Për shkak të mungesës së resurseve të përshtatshme dhe vullnetit të nevojshëm politik në të gjithë nivelet, ngadalësime dhe mangësi serioze janë raportuar në implementimin e strategjisë nacionale dhe planit për veprim për romët dhe jo çdoherë ato të cilëve u janë dedikuar nuk kanë përfituar nga masat e miratuara. Komiteti këshillues vëren se edhe pse janë caktuar fonde nga ministritë e ndryshme përkatëse, pjesa më e madhe e resurseve të mbledhura vijn nga donacione ndërkombëtare dhe kjo paraqet problem për sigurimin e vazhdimësisë.

55. Komiteti këshillues me brengosje vëren se 70% e popullatës romë jetojnë në vende joligjore me kërcënim të vazhdueshëm për dëbim dhe ku shpesh mungojnë shërbimet dhe infrastrukturë themelore si uji, rryma dhe qasja në rrugët. Ngjajshëm, përderisa problemi i punësimit është problem i përgjithshëm dhe prek të gjithë komunitetet<sup>v</sup>, si shumicën ashtu edhe minoritetet, më të prekur janë romët<sup>vi</sup>, me tani përafërsisht 70% jashtë nga punësimi formal. Në përgjithësi romët kanë shansa të vogla për të gjetur punë për shkak të nivelit të ulët të ndjekjes së arsimit (shumica vetëm shkollën fillore) dhe kualifikimeve të dobëta si dhe për shkak të diskriminimit në tregun e punës.

56. Disa nga përfaqësuesit e romëve deklarojnë se romët sistematikisht janë përjashtuar nga baza e të dhënave në qendrat për punësim;<sup>vii</sup> sipas agjencive për punësim aryeja qëndron në mungesën e shkollës fillore, e cila duket se është kërkesa themelore për qasje në tregun e punës dhe në benefitet sociale. Sidoqoftë, sipas autoriteteve kjo nuk është kërkesë për inkuadrim në bazën e të dhënave në fjalë dhe se nuk është i drejtë një interpretim i tillë i rregullave ekzistuese në këtë fushë. Komiteti këshillues është informuar se Ministria e punës dhe politikës sociale ka lëshuar udhëzime për sqarimin e duhur të kësaj materie. Gjithashtu, OJQ-të romë kanë nxjerr në pah se edhe pse programe dhe projekte për punësim janë implementuar nga Qeveria disa në vitet e fundit me ndihmën e institucioneve ndërkombëtare, romët shpesh janë të përjashtuar nga ato duke qenë se ato nuk janë të aftë të plotësojnë kërkesat themelore arsimore për pjesëmarrje. Gjendja e tyre e pasigurtë kërkon veprim me përparësi dhe të fokusuar nga Qeveria.

57. Edhe më tutje raportohen probleme serioze sa i përket qasjes së romëve në ndihmën sociale dhe kujdesin shëndetësor, ku shpesh raportohen sjellje armiqësore dhe praktika diskriminuese sic janë refuzimi i trajtimit dhe ndarje në spitale. Shumica e romëve nuk mund të marrin barnat dhe trajtimet themelore dhe nuk janë në gjendje të paguajnë cmimin, edhe pse minimal, për barnat dhe vizitat te mjeku.

58. Gjendja e grave romë është posacërisht shqetësuese. Përveç problemeve me të cilët ato ballafaqohen në arsim, punësim dhe shëndetësi, gratë romë shpesh ndeshen me diskriminimin jashtë dhe brenda komunitetit. Komiteti këshillues vëren se për të përmirësuar gjendjen e tyre projekte specifike janë vendosur në sektore të ndryshme. Aktivitete për ngritjen e vetëdijes janë zhvilluar për çështje lidhur me të drejtën e arsimit, shëndetësisë dhe riprodhimit, që përveç grave romë kanë për target edhe institucionet publike përkatës. Pavarësisht këtyre hapave pozitive, të nevojshme janë përpjekje më të vendosura dhe më të fokusuara që do të sigurojnë se masat e marra kanë ndikimin e vërtetë në gjendjen e personave me interes.

59. Problemet për të patur qasje në arsim, sjelljet arsimore dhe praktikat e ndarjeve me të cilët ballafaqohen romët mbeten sfida për autoritetet, edhe pse janë bërë përpjekje thelbësore dhe përparim është evidentuar në këtë fushë (në lidhje me këtë shih komentet në nenin 12 më poshtë).

60. Edhe pse disa mijëra romë kanë pranuar ndihmë (përfshirë edhe ndihmë financiare) për të marrë dokumentet e identifikimit, një numër domethënës i tyre ende nuk kanë certifikatat e lindjes apo dokumentet e identifikimit. Ata përbëjnë një pjesë të madhe të atyre që ende nuk kanë marrë shtetësinë e vendit, përkundër ndryshimeve të legjislacionit për t'ua lehtësuar këtë. Me këtë problem ballafaqohen edhe personat që i përkasin komunitetit shqiptar. Komiteti këshillues është i brengosur për këtë situatë, sidomos duke patur parasysh se Qeveria në deklaratën e korigjuar ka kufizuar shtrirjen personale të Konventës kornizë në ata që kanë shtetësinë e vendit (shih gjithashtu edhe vërtetimet në nenin 3 më poshtë).

61. Sidoqoftë, romët nuk janë komuniteti i vetëm i prekur nga vështirësitë socio-ekonomike. Sipas përfaqësuesve të tyre, shumë turkë ndeshen me probleme serioze socio-ekonomike, sidomos në fushën e punësimit, si dhe me praktika diskriminuese dhe problem në qasjen në arsim në disa regjione. Problemet e banimit gjithashtu vazdojnë të ndikojnë në personat që i takojnë këtij komuniteti, sidomos në vende rurale.

62. Vështirësitë me të cilat ballafaqohen gratë e komuniteteve etnike përveç atij romë (sidomos atij shqiptar dhe turk) në arsim, punësim dhe shëndetësi bëjnë që këto gra të jenë më të dobëta ndaj diskriminimit. Në të vërtetë duket se këta gra shpesh janë subjekt i vështirësive dhe diskriminimit të shumëfishtë si në komunitetin e tyre ashtu edhe në shoqëri. Komiteti këshillues vëren se gjendja e tyre gjithnjë e më shumë po bëhet prioritet për veprim të Qeverisë në bashkëpunim me OJQ-të dhe përshëndet faktin që vet gratë janë të mobilizuara për të adresuar problemet e tyre dhe për të rritur pjesëmarrjen e tyre në shoqëri (në këtë drejtim, shih gjithashtu komentet në nenin 15 më poshtë).

#### *Rekomandime*

63. Për të siguruar implementimin e plotë dhe efektiv të Startegjisë nacionale për romët dhe Planit aksionar të miratuar nga Qeveria, autoritetet duhet në bashkëpunim të ngushtë me romët të përshpejtojnë përpjekjet e tyre. Vlerësime të rregullta të pamvarura duhet të zhvillohen për implementimin e Strategjisë dhe urgjentisht duhet ndërmarrë për të luftuar diskriminim ndaj romëve në cdo fushë. Sidomos, duhet eliminuar cdo kërkesë e tepërt për t'u regjistruar në agjensitë e punësimit. Ato duhet edhe më tutje të lehtësojnë marrjen e dokumenteve të identifikimit dhe të ndihmojnë romët si dhe personat tjerë që kanë interes të marrin shtetësinë.

64. Ngjajshëm, masa më të fuqishme janë të nevojshme për të luftuar problemet socio-ekonomike me të cilët ballafaqohen personat që u përkasin komuniteteve të tjera, sidomos atij turk.

65. Autoritetet duhet përgjigjur me masa të fokusuara për të rritur vetëdijen dhe për të dhënë ndihmë në fushat relevante, për të përmirësuar gjendjen e grave që u përkasin komuniteteve të ndryshme etnike. Sidomos, vështirësitë me të cilat ballafaqohen gratë rome në qasjen e tyre drejt punësimit, kujdesit shëndetësor dhe arsimit kërkojnë veprim urgjent. Resurse të përshtatshme duhet caktuar për të siguruar implementim efektiv të Ligjit për barazi gjinore, gjithashtu edhe në dobi të personave që u përkasin minoriteteve etnike.

## **Neni 5 i Konventës kornizë**

### **Ruajtje e kulturës së personave që u përkasin minoriteteve kombëtare**

#### *Zbulime nga cikli i parë*

66. Në Opinionin e tij të parë, Komiteti këshillues zbuloi se mbështetja e shtetit për të promovuar identitetin kulturor të komuniteteve të ndryshme, përfshirë edhe trashigimin e tyre historike, ishte e papërshtatshme dhe Komiteti nxiti autoritetet të marrin hapat e duhura për të korrigjuar këtë.

67. Komiteti këshillues vërejtë brengosjen e përfaqësuesve të vllahëve sa i përket mbijetesës së identitetit të tyre kulturor, që ata mendojnë se është në rrezik nga asimilimi dhe nxiti autoritetet të japin mbështetje më të madhe ruajtjes së identitetit të këtij komuniteti.

#### *Gjendja e tanishme*

##### a) Zhvillime pozitive

68. Mbrojtja e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar i komuniteteve së bashku me mbrojtjen e të drejtës së shprehjes së lirë, kultivimit dhe zhvillimit të tipareve të identitetit të tyre dhe përdorimit të simboleve të komuniteteve është e garantuar me nenin 48 të Kushtetutës. Komiteti këshillues vëren se në përputhje me këto dispozita në vitin 2005 është miratuar ligji i ri i cili mbron të drejtën e komuniteteve etnike për përdorimin e flamujve në komunat ku 50% të popullatës përbëjnë personat që i përkasin komunitetit etnik ndryshe nga shumica. Në praktikë, ky ligj lidhet me komunitetin shqiptar pasi vetëm ky komunitet plotëson përqindjen e kërkuar dhe zbatohet në 16 prej 84 komunave në vend.

69. Sipas Raportit shtetëror, ndryshimet e Ligjit për kulturë nga viti 2003 kanë krijuar kushte më të mira për financimin e projekteve kulturore të minoriteteve kombëtare si dhe për përfaqësimin e këtyre të fundit në Këshillin kulturor. Përveç kësaj, programet kulturore vjetore janë publikuar nga Ministria e kulturës edhe në gjuhët e komuniteteve që përfaqësojnë më shumë se 20% të popullatës. Në aspektin institucional, departamenti në Ministrinë e kulturës përgjegjës për promovimin dhe zhvillimin e kulturës së komuniteteve etnike ka për detyrë të ndihmojë ruajtjen dhe zhvillimin e kulturave të minoriteteve duke inkurajuar organizatat e minoriteteve etnike të dorëzojnë projekte kulturore të cilësisë së lartë dhe të sigurojë se këto projekte janë të trajtuara në mënyrë

jodiskriminuese. Zyrtarët e lartë dhe stafi i Ministrisë së kulturës përfshijnë edhe përfaqësues nga komunitetet e ndryshme, poashtu edhe komisionet përgjegjëse për zgjedhjen e projekteve.

70. Komiteti këshillues vëren se shumë aktivitete kulturore të promovuara nga minoritetet kombëtare (shqiptar, turk, vllahë, serb, romë dhe boshnjak) kanë pranuar financim vjetor nga Ministria e kulturës si projekte kulturore me interes kombëtare. Shteti ka mbështetur gjithashtu projektet për hulumtim, arkeologji, bibliografi, dhe të tjera hulumtime përkushtuar historisë dhe kulturës së minoriteteve dhe të promovuara nga muzejet, dhe institutet për hulumtime etnologjike, historike, etj. (për hollësi shih Raportin shtetëror). Vëmendja mund të tërhiqet nga zhvillimet pozitive në ruajtjen dhe restaurimin e monumenteve kulturore dhe historike të minoriteteve kombëtare, përfshirë këtu edhe shumë shembuj nga arkitektura islamike. Komiteti këshillues gjithashtu vëren përparim në procesin e kthimit të pronave fetare (Kishës ortodokse maqedonase, dhe Bashkësisë fetare islame).

71. Decentralizimi kulturor i siguar me legjislacionin për vetëqeverisjen lokale dhe me ndryshimet e Ligjit për kulturën, duhet gjithashtu të ofroj kushte më të favorshme për afirmimin e kulturave të komuniteteve dhe natyrës shumëkulturore të shtetit. Komunat tani kanë përgjegjësi më të madhe për mbështetje financiare dhe institucionale të projekteve kulturore dhe institucioneve me domethënie të vecantë lokale, për vendimmarrje sa u përket monumenteve historike dhe festimeve, etj. Përkundër problemeve të pandara në fazën fillestare të decentralizimit, mbetet të shpresohet se procesi do të jetë i dobishëm për ruajtjen dhe zhvillimin e kulturave të komuniteteve të ndryshme.

#### b) Cështje të diskutueshme

72. Përderisa bëhen shënime të aktiviteteve të shumta kulturore të minoriteteve që kanë pranuar ndihmë nga autoritetet, Komiteti këshillues vëren se fondet e dhuruara nga shteti llogariten nga minoritetet si të pamjaftueshme për nevojat e tyre dhe sidomos nga kjo janë të prekura minoritetet më të vogla, përfshirë edhe ato të cilat nuk janë të përmendura në Kushtetutë. Sipas përfaqësuesve të këtyre të fundit, për shkak të ballafaqimit të tyre me gjendjen e rëndë financiare, ndihma nga shteti është thelbësore për ruajtjen e kulturës dhe identitetit të këtyre komuniteteve dhe autoritetet duhet të bëjnë më shumë përpjekje për t'i përkrahur ata.

73. Romët kanë shprehur pakënaqësinë e tyre pasi shteti nuk ka përkushtim të mjaftueshëm për të inkurajuar pjesëmarrjen e tyre në jetën kulturore dhe kanë nxjerr në pah mungesën e interesit të autoriteteve për të financuar hulumtimet historike në kulturën dhe traditat e komunitetit të tyre. Ngjajshëm edhe vllahët kanë raportuar probleme serioze në gjetjen e resurseve të nevojshme për të mbajtur gjallë identitetin e tyre, të cilët mendojnë se është në rrezik të zhdukjes.

#### *Rekomandime*

74. Në bashkëpunim me përfaqësuesit e minoriteteve autoritetet duhet të identifikojnë mjetet financiare për përmirësimin dhe qasjen e minoriteteve kombëtare në ndihmën financiare nga shteti për aktivitet kulturore.

75. Kujdes i përshtatshëm duhet kushtuar mbështetjes së komuniteteve të vogla, përfshirë edhe ato të cilët nuk janë të përmendura në Kushtetutë, në ruajtjen dhe afirmimin e identitetit të tyre nëpërmjet procedurave të qarta dhe transparente.

## **Neni 6 i Konventës kornizë**

### **Toleranca dhe dialogu ndërkulturor**

#### *Zbulime nga cikli i parë*

76. Në Opinionin e tij të parë, Komiteti këshilloes ka nxitur autoritetet qendrore dhe lokale për të bërë përpjekje më të vendosura për të promovuar tolerancën dhe marrëdhëniet ndërkulturore. Për shkak se ka vërejtur shkallë të ulët të ndërveprimit mes grupeve të ndyshme etnike, sidomos mes shqiptarëve dhe maqedonasve, Komiteti u ka bërë thirrje autoriteteve të luftojn ndarjen e shoqërisë në baza etnike sidomos në fushën e arsimit.

77. Për më shumë, masa plotësuese ishin të nevojshme për të inkurajuar mediat në raportimin e balancuar të çështjeve për minoritetet.

78. Autoritetet janë nxitur gjithashtu të kushtojn vëmendje të vecantë romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve të cilët janë arratisur nga Kosova dhe të cilët ende jetojnë në "ish Republikën jugosllave të Maqedonisë" në kushte të varfërisë së skajshme, që i degdisë ato në thekë të shoqërisë.

#### *Gjendja e tanishme*

##### a) Zhvillime pozitive

79. Komiteti këshilloes vëren zhvillim pozitiv të përparimit të bërë në disa vite të fundit në mirëkuptimin dhe dialogun ndërkulturor dhe në marrëdhëniet mes dy komuniteteve të mëdha. Implementimi progresiv i parimit të përfaqësimit të barabartë si faktor, sëbashku me masat e miratuara për ngritjen e vëmendjes në të njëjtën kohë, thelbësisht kanë kontribuar në këtë trend pozitiv.

80. Sic është thënë në Raportin shtetëror, mirëkuptimi ndëretnik në arsim është prioritet për Programën nacionale për zhvillimin e arsimit për periudhën 2005-2015 dhe programet shkollore përmbajn dispozita për promovimin e tolerancës dhe respektit të ndërsjelltë në shkollat fillore dhe të mesme nëpërmjet orëve të arsimit qytetar dhe lëndëve tjera. Përveç kësaj, shumë projekte të implementuara nga Ministria e arsimit në bashkëpunim me OJQ-të, të cilët në shumë raste janë të organizuar me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare, janë përkushtuar ngritjes së vetëdijes për tolerancë dhe respekt ndaj shumëllojshmërisë.

81. Komiteti këshilloes vëren këto zhvillime pozitive dhe nismat e zhvilluara në këtë fushë nga shoqëria civile. Sidomos vëren projektet e implementuara nga organizatat e grave të minoriteteve për promovimin mirëkuptimit të ndërsjelltë dhe dialogut, sidomos për të zbutur tendosjet të shkaktuara, poashtu edhe në mes të fëmijëve, nga paraqitja e klasave plotësuese në gjuhën shqipe. Vlejnë të përmenden aktivitetet për ngritjen e vetëdijes së grave këshilltare lokale dhe anëtare të Parlamentit dhe që janë zhvilluar nga rrjeti shumë etnik i organizatave të grave.



82. Komiteti këshillues me kënaqësi vëren informatat sipas të clave jo vetëm personat që u përkasin minoriteteve bëjnë përpjekje për të mësuar gjuhën maqedonase por ka tendencë tek shumica për të mësuar gjuhën shqipe sidomos në rajone me popullatë të përzier. Komiteti këshillues shpreson se kjo do të sjell deri në mirëkuptim të ndërsjelltë dhe dialog më të mire mes maqedonasve dhe shqiptarët.

b) Cështje të diskutueshme

83. Përderisa më lartë përshëndetet progresi, Komiteti këshillues vëren se shoqëria e "ish Republikës jugosllave të Maqedonisë" mbetet e ndarë në baza etnike dhe se edhe më tutje janë të nevojshme përpjekje të vendosura për të arritur pajtim mes maqedonasve dhe shqiptarët. Në përgjithësi, depolitizimi i çështjeve etnike dhe deetnitizimi i debateve politike dhe vendimarrjes do të kishin kontribuar mjaft në arritjen e këtij qëllimi.

84. Komiteti këshillues është thellë i brengosur nga fakti që, sic është thënë edhe në shumë burime, ndërveprimi mes personave që u përkasin këtyre dy komuniteteve mbetet i kufizuar dhe në komunat dhe rajonet e prekura nga lufta si për shembull në Tetovë ende duhet tejkaluar sjelljet e mbyllura dhe mungesa e besimit. Këto pengesa të ndërveprimit janë edhe më shqetëuese pasi prekin edhe të rinjtë, në shkolla, në jetën e përditshme, në vende publike për argëtim dhe në aspekte tjera të jetës së tyre sociale. Përpjekjet e OJQ-ve për të bashkuar të rinjtë e komuniteteve të ndryshme nuk kanë patur cdoherë përkrahjen e mjaftueshme nga autoritetet dhe kanë patur shumë pak ndikim (gjithashtu shih vrojtimit në nenin 12 më poshtë).

85. Sa u përket personave që u përkasin minoriteteve të vogla (sic janë vllahët, turqit, serbët dhe boshnjakët) edhe sikur ato të mos kenë problem në integrimin dhe pranimin e tyre në shoqëri, ato edhe më tutje mendojnë se kontributi i tyre në shumëllojshmërinë dhe pasurinë e shoqërisë nuk është mjaft i vlerësuar.

86. Komiteti këshillues është informuar se mediat, të cilat mund të luajn një rol të rëndësishëm në integrim, edhe më tutje nuk janë objektive në mbulimin e komuniteteve të ndryshme dhe ndonjëherë japin pasqyrë të njëanshme për disa grupe etnike. Në vend që të promovojn dialogun ndëretnik dhe të mirëkuptimin e ndërsjelltë, disa media si duket pëlqejn të favorizojn përmbajtjet etnike dhe të politizojn me të madhe çështjet etnike për qëllime politike dhe komerciale. Me sa duket, aktivitetet për ngritjen e vetëdijes dhe përpjekjet për të zbatuar Kodin e sjelljes në mesin e gazetarëve nuk kanë ndikim të mjaftueshëm në parandalimin e mediave në përhapjen e stereotipeve etnike dhe sjelljeve negative. Dispozitat e nenit 319 të Kodit penal që inkriminojnë nxitjen e urrejtjes janë të përdorura shumë rrallë.

87. Edhe pse numri i tyre është zvogëluar shumë, vendi ende duhet të merret me problemet me të cilët ballafaqohen romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët të cilët janë aratisur nga Kosova, gjendja juridike e të cilëve është ende e paqartë dhe në cdo aspekt janë në gjendje të dobët (kushte të rrezikshme për jetesë, problem për qasje në të drejtat socio-ekonomike, arsim, etj.) Komiteti këshillues vëren se autoritetet janë plotësisht të vetëdijshëm për këtë dhe janë shumë të brengosur për nivelin e këtyre problemeve dhe përkundër mungesës së resurseve janë bërë përpjekje për të zgjedhur këto problem. Më tutje, Komiteti vëren raportet lidhur me zbatimin nga autoritetet, në fund të vitit 2006, të udhërave të parë për dëbimin e një numri të madh të kërkuesve të azilit nga Kosova (diku 400 persona) kërkesat e të cilëve janë refuzuar në shkallën e apelit. Pasi asnjë nga

vendimet e shkallës së parë nuk ëshë ndryshuar në shkallën e apelit, disa OJQ për të drejtat e njeriut kanë vënë në pyetje përshtatshërinë e këtyre masave dhe seriozisht kanë kritikuar procedurat e apelit. Komiteti këshillues mendon se autoritetet duhet t'i shohin këto deklarata.

#### *Rekomandim*

88. Autoritetet duhet të përforcojnë përpjekjet e tyre për të bashkojnë personat nga komunitetet e ndryshme, sidomos në vende të përziera dhe të intesifikojnë masat për ngritjen e vetëdijes në të gjithë mjediset e rëndësishme: shkolla, autoritetet lokale, media, system juridik, etj. Ngjajshëm, me rëndësi është të sigurohet harmonizim i legjislacionit ekzistues nga të gjitha sektoret për të luftuar diskriminimin, urrejtjen dhe intolerancën.

89. Me rëndësi është të ruhet mbulimi neutral dhe objektiv i çështjeve etnike nga mediat dhe të largohen shtypjet e bëra në mediat nga partitë politike. Në këtë fushë vetëdija duhet zhvilluar nëpërmjet të trajnimit plotësues dhe masa automatike për media profesionistët, të cilat duhet të kontribojnë edhe në përmirësimin e profesionalizmit dhe objektivitetit të gazetarëve. Vëmendje të madhe duhet kushtuar vëzhgimit të mbulimit të çështjeve etnike nga mediat.

90. Kujdes i vecantë duhet kushtuar gjendjes së romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve që janë aratisur nga Kosova, dhe autoritetet duhet të sigurojnë se gjatë sjelljes së masave lidhje me këtë është marr parasysh gjendja specifike e këtyre personave me qëllim të plotësimit të nevojave të tyre.

### **Veprimi policor dhe të drejtat e njeriut**

#### *Zbulime nga cikli i parë*

91. Në Opinionin e tij të parë, Komiteti këshillues ka vërejtur raste shqetësuese të dhunës dhe keqtrajtimit të shkaktuara nga policia ndaj personave që u përkasin minoriteteve, sidomos atij romë dhe shqiptarë, dhe faktin se këto raste rallë shkojnë në gjykata. Autoritetet janë ftuar të ekzaminojnë gjendjen dhe të ndërmarrin një hetim në lidhje me mënyrën e trajtimit të këtyre ankesave për këto veprime nga ana e policies.

#### *Gjendja e tanishme*

##### a) Zhvillime pozitive

92. Komiteti këshillues me kënaqësi vëren se, pas kuptimit të sinqertë të problemeve dhe nevojave në këtë fushë, policia i është nënshtuar një refome të madhe dhe është miratuar një Ligj i ri për policinë për të siguruar përputhje të plotë me standardet europiane. Të drejtat e njeriut tani janë lëndë e vecantë në shkollën policore, dhe ka filluar bashkëpunim me OJQ-të për të identifikuar prioritet për veprim në këtë fushë në baza të rregullta. Kod për sjelljen e punëtorëve të policisë është miratuar në janar të vitit 2004 dhe është një ndër lëndët që studiohen në trajnimet e punëtorëve të policisë. Në përgatitje është një lëndë e re që do të mbulojë specifikat e punës së policisë në mjedisë shumë kulturore.

93. Në praktikë, patrullat e policisë shumë etnike janë vendosur në vende ku jetojnë banorë nga komunitete të ndryshme etnike dhe rezultatet e para duket të jenë inkurajuese. Për këtë shkak, autoritetet duan të aplikojnë këtë qasje shumëkulturore në gjithë vendin.

94. Komiteti këshillues gjithashtu vëren se njësia e inspektimit policor në Ministrinë e punëve të brendshme përbëhet edhe nga përfaqësues të grupeve të ndryshme etnike dhe gjithashtu kjo njësi i është nënshtruar reformës.

b) Cështje të diskutueshme

95. Përkundër masave të përmednura më lartë, burimet joqeveritare edhe më tutje raportojnë probleme me të cilët ballafaqohen romët në marrëdhëniet e tyre me policinë. Kështu, raporte të fundit flasin për sjellje diskriminuese, sjellje armiqësore dhe sjellje të keqe nga disa punëtorë të policisë ndaj romëve, që në të vërtetë në më shumë raste keqtrajtimet.

96. Të njëjtët burime tregojnë mosveprimin dhe veprimin jo adekuate të policisë dhe gjykatave në lidhje me këto raste dhe theksojnë se cështjet e diskriminimit dhe intolerances nuk janë mjaftë të njohura dhe hulumtuara.

*Rekomandim*

97. Autoritetet duhet të vazhdojnë dhe të zgjerojnë masat e tyre për ngritjen e vetëdijes në mesin e anëtarëve të forcave policore në lidhje me respektin ndaj shumëllojshmërisë dhe të drejtave të njeriut dhe duhet të përshpejtojnë përpjekjet për angazhimin e romëve në polici.

98. Në të njëjtën kohë duhet të sigurojnë mekanizma efektiv dhe të pamvarur të mbikëqyrjes për të vëzhguar sjelljen e policëve dhe të sigurojnë se ndëshkime të përshtatshme zbatohen në raste të dhunës së të drejtave të njeriut nga ana e policisë. Përvec kësaj, duhet të ketë më shumë trajnime dhe ngritje të vetëdijes së aëtarëve të gjykatave në lidhje me tolerancën dhe cështjeve të antidiskriminimit.

**Neni 7 i Konventës kornizë**

**E drejta e të menduarit, vetëdijes dhe religjionit**

*Gjendja e tanishme*

99. Komiteti këshillues me interes ka marr shënime për informatat në lidhje me planifikimin e Qeverisë për të paraqitur religjionin si lëndë shkollore. Komiteti këtu dëshiron të theksoj se në sjelljen e masave të këtilla duhet patur parasysh nevojat dhe ndjeshmëritë e personave që u përkasin minoriteteve kombëtare dhe sipas rrethanave, e drejta e lirisë së religjionit dhe manifestimit të religjionit dhe besimit të këtyre personave.

*Rekomandim*

100. Poqese edukimi religjioz paraqitet në shkollat shtetërore, autoritetet në përpunje me parimet e Konventës dhe në konsultim me familjet duhet të sigurojnë se ky edukim do të

zhvillohet në përputhje të plotë me të drejtën e lirisë së mendimit, vetëdijes dhe religjionit të personave që u përkasin minoriteteve. Sidomos, me rëndësi është të sigurohet se këto orë nuk përmbajnë kurse obligative për nxënësit të cilët vejnë theks në ndonjë nga religjionet apo besimet (shih gjithashtu vrojtimit në nenin 12 më poshtë).

## **Neni i 8 i Konventës kornizë**

### **E drejta e manifestimit të religjionit dhe e themelimit të institucioneve, organizatave dhe shoqërive religjioze**

#### *Zbulime nga cikli i parë*

101. Në Opinionin e tij të parë, Komiteti këshillues ka vërejtur se ekzistojnë paqartësi në mes të personave që u përkasin minoriteteve në lidhje me procedurën e regjistrimit të komuniteteve religjioze në bazë të vendimit kushtetues me të cilin ndryshohet Ligji për komunitetet dhe grupet religjioze nga viti 1997. Autoritetet ishin të nxitur të sqarojnë procedure për të cilën bëhet fjalë me qëllim që të lehtësohet regjistrimi i komuniteteve të ndryshme religjioze.

#### *Gjendja e tanishme*

##### a) Zhvillime pozitive

102. Nga fundi i dhjetorit të vitit 2006, një projektligj për kishat, komunitetet dhe grupet religjioze ishte në process të finalizimit nga Qeveria. Përveç karakteristikave tjera, projektligji do të ndryshoj procedure e regjistrimit të komuniteteve religjioze, të cilat që atëherë do të regjistrohen në gjykata kompetente e jo në organ qeveritar. Sipas autoriteteve ka patur konsultim paraprak me palët e interesuara dhe gjithashtu është planifikuar të dorëzohet ligji për vlerësim nga organizatat ndërkombëtare.

##### b) Çështje të diskutueshme

103. Komiteti këshillues vëren se përkundër vendimeve të Gjykatës kushtetuese në lidhje me këtë, edhe më tutje ngelin paqartësi për procedurat e regjistrimit dhe për kërkesat që duhet t'i plotësojnë grupet religjioze sipas legjislacionit ekzistues (Ligji për komunitetet dhe grupet religjioze nga viti 1997). Përfaqësuesit e disa grupeve (serbe dhe vllehe) posaçërisht kanë kritikuar dispozitat e Ligjit sipas të cilave vetëm një komunitet mund të regjistrohet në kuadër të një besimi. Këta mendojnë se këto dispozita janë potencialish diskriminuese për derisa regjistrimi i komunitetit religjioz është parakusht për të ndërtuar kasha dhe për të ushtruar aktivitete të shumta religjioze. Deri tani nuk është e qartë se projektligji i tanishëm a do t'u përgjigjet këtyre brengosjeve.

#### *Rekomandime*

104. Autoritetet duhet të sigurojnë se edhe në ligj edhe në praktikë plotësisht respektohet e drejta e minoriteteve për të manifestuar religjionin dhe besimet e tyre, dhe për të themeluar institucione, organizata dhe shoqata religjioze. Ato gjithashtu duhet të sigurojnë se legjislacioni i ri i cili po hartohet në lidhje me këtë, në përputhje me nenin 8 të Konventës kornizë, do të parashoh të gjithë kushtet e nevojshme për ushtrimin efektiv të kësaj të drejte dhe se në procesin legjislativ në mënyrë adekuate janë marr parasysh opinionet e komuniteteve religjioze.

## Neni 9 i Konventës kornizë

### Qasja në media e personave që u përkasin minoriteteve kombëtare

#### *Zbulime nga cili i parë*

105. Në Opinionin e tij të parë, Komiteti këshillues nxiti autoritetet të adresojnë problemet në punën e kanalit të tretë televiziv publik, i cili transmeton në gjuhët e minoriteteve, për të garantuar cilësinë dhe realizshmërinë e tij.

106. Komiteti këshillues vërejt se kërkesa ligjore që përveç në gjuhën e minoriteteve të transmetohet edhe në gjuhën maqedonase ka vështirësuar marrjen e licencës për transmetime private në gjuhën e komunitetëve të ndryshme. Komiteti nxiti autoritetet të adresojnë këtë gjendje në lidhje me rishikimin e Ligjit për transmetim. Autoritetet u ftuan të fokusohen më shumë në brengat e shprehura nga minoritetet e vogla për qasjen e tyre në media.

#### a) Zhvillime pozitive

107. Bazat ligjore për aksesin e personave që iu përkasin minoriteteve kombëtare në media janë përforcuar me Ligjin e ri për transmetim të miratuar në vitin 2005. Ligji i ri qartë kërkon nga shërbimet publike të radios dhe televizionit si dhe inkurajon operatorët privat të transmetojnë programe për kulturat dhe punët e minoritetëve kombëtare në gjuhë tjera nga gjuha maqedonase që fliten nga mbi 20% e popullatës (shqip) si dhe në gjuhët e komuniteteve tjera.

108. Sipas Ligjit të ri, operatorët privat që transmetojnë programe në gjuhët e minoriteteve kombëtare nuk janë të detyruara të transmetojnë edhe në gjuhën maqedonase. Nga ana tjetër, transmetimi në gjuhët e minoriteteve është një nga kriteret që merret parasysh në dhënien e licencës dhe konsiderohet të jetë në interes publik. Përveç kësaj, Ligji kërkon nga operatorët të përkushtojnë së paku 30% nga koha e transmetimit ditor të tyre programeve origjinale të prodhuara në Maqedoni ose në gjuhët e minoriteteve, ky minimum është rritur në 40% nga transmetimi ditor i radios publike. Komiteti këshillues nuk ka arritur të marrë deri tani informatë për përqindjen e vërtetë të programeve në gjuhët e minoriteteve të ndryshme.

109. Komiteti këshillues më tutje vëren se ligji i ri përmban dispozita të veçanta për të siguruar përfaqësim më të mirë të minoriteteve në organet drejtuese të transmetuesve publik dhe në vendim marrjen në nivel të këtyre organeve përmes përdorimit të parimit të shumicës së dyfishtë në vendimet që prekin minoritetet (shih vrojtimit nën nenin 15 më poshtë).

110. Në kushte të praktikës, Komiteti vëren se stacioni i dytë i televisionit publik (MTV2), që mbulon gjithë shtetin, tani në tërësi i është kushtuar programeve për komunitetet etnike në gjuhën e tyre, dhe këto programe janë të prodhuara nga ekipe që përbëhen nga persona që iu përkasin komunitetëve të ndryshme. Ngjajshëm edhe radio publike transmeton programe në gjuhët e komuniteteve të ndryshme në nivel lokal dhe shtetëror. Komiteti këshillues ka vërejtur gjithashtu se në progres janë diskutimet për gjetjen e rrugës më të mirë të plotësohen nevojat e grupeve të vogla etnike në strategjinë për transmetim për pesë vitet e ardhshme.

111. Në sferën e mediave private, mund të vërehet si pozitive që në vitin 2004 është themeluar stacion televiziv në gjuhën shqipe (ALSAT) që ka mbulim në nivel shtetëror, që gjithashtu transmeton lajmet edhe në gjuhën maqedonase. Sa u përket romëve, ka dy stacione televizive private romë, të cilat më shumë janë komerciale dhe transmetojn programe në gjuhën e romëve në Shkup. Ngjajshëm, stacion provincial i radios (në Kumanovë) transmeton programe në gjuhën e romëve dy herë në javë. Komiteti këshillues gjithashtu përshëndet hapjen e fundit të një portali të internetit në shumë gjuhë të servisit të radios dhe televizionit, i cili siguron informata gjithashtu në gjuhët e komuniteteve të ndryshme etnike.

112. Komiteti këshillues gjithashtu vëren se, sipas Raportit shtetëror, 28 publikime të shtypura në shqip dhe në serbisht janë regjistruar në fund të vitit 2005. Përveç kësaj, vllhët kanë një revistë që del dy herë në muaj dhe ekzistojnë disa publikime në gjuhën e romëve, edhe pse për shkak të vështirësive financiare ato nuk publikohen rregullisht. Komiteti këshillues vëren se gazetarët romë tani po trajtohen nga Instituti maqedonas për media.

b) Çështje të diskutueshme

113. Komiteti këshillues vëren se, sipas përfaqësuesve të komuniteteve të vogla etnike, ato kanë numër të kufizuar të programeve në stacionet lokale të radios dhe mediat nuk kushtojnë shumë vëmendje brengave të tyre. Në fushën e mediave të stypit, këto komunitete ballafaqohen me probleme serioze financiare, që e bëjnë të pamundshëm kontinuitetin e tyre.

114. Komiteti këshillues është i brengosur për informatën se në praktikë programet e transmetuara nga mediat e komuniteteve të ndryshme janë të menduara dhe u përkushtohen vetë atyre komuniteteve dhe ka shumë pak komunikim dhe ndërveprim mes personave që iu përkasin grupeve të ndryshme nëpërmjet mediave. Mungesa e vërtetë e dialogut është sidomos e qartë dhe shqetësuese në relacionet mes maqedonasve dhe shqiptarëve, të cilët kanë vështirësi në gjetjen e bazës së përbashkët për komunikim në media. Grupet e vogla kanë problem në gjetjen e vendit të tyre në këtë kontekst (shih gjithashtu komentet në nenin 6 më lartë).

115. Shumë burime kanë vënë në dukje problemin serioz në lidhje me varshmërinë politike të tepruar të mediave, që e bëjnë të vështirë ato të sigurojnë trajtim të balancuar të çështjeve në lidhje me minoritetet. Përveç kësaj, është rritur brengosja për standardet profesionale të gazetarisë dhe ndikimi i kësaj gjendje në cilësinë e programit dhe në aftësinë e mediave të paguajnë që do të ketë rol pozitiv si mjet për integrim dhe do të jetë fushë për dialog për komunitetet e ndryshme.

*Rekomandime*

116. Komiteti këshillues nxit autoritetet të fokusohen më shumë në nevojat për akses në media të gupeve me numër më të vogël dhe në bazë të legjisllacionit në fuqi, të gjejnë mënyra për përmirësimin e gjendjes së këtyre personave në këtë fushë.

117. Autoritetet duhet të zhvillojnë dhe përkrahin nismat për rritjen e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe dialogut ndërkulturor nëpërmjet mediave. Përderisa plotësisht respektohet pavarësia redaktuese e mediave, ata duhet të identifikojnë mjetet financiare

për të inkurajuar këto të fundit të zhvillojnë programe multikulturore dhe të promovojnë dialog mes komuniteteve të ndryshme nëpërmjet përmbajtjes dhe nëpërmjet zgjedhjes më përfshirëse për pjesëmarrje në media dialogun.

118. Vëmendje më të madhe duhet kushtuar trajnimit profesional të gazetarëve dhe profesionistëve tjerë të mediave, sidomos atyre të cilët punojnë në mjedis multikulturorë. Përpjekjet e bëra nga vetë mediat dhe nga shoqatat e media profesionistëve për të përforcuar sistemin e tyre për vetë rregullim dhe vetë monitorim duhet të inkurajohen dhe përkrahen.

#### **Neni 10 i Konventës kornizë**

##### **Përdorimi i gjuhëve të minoriteteve në autoritetet publike dhe nga autoritetet publike**

###### *Zbulime nga cikli i parë*

119. Në Opinionin e parë, Komiteti këshillues nxiti autoritetet të formulojnë në ligj garancat kushtetuese lidhur me përdorimin e gjuhëve të minoriteteve në komunikim nga dhe me autoritetet publike, përfshirë edhe legjisalcionin e ardhshëm për përdorimin e gjuhëve dhe alfabetëve.

120. Komiteti këshillues gjithashtu ka vërejtur mungesë të përkthyesve të nevojshëm për përdorimin e gjuhëve të minoriteteve në procedurat gjyqësore dhe u është drejtuar autoriteteve të zhvillojnë programe speciale trajnimi për ta plotësuar këtë mungesë.

###### *Gjendja e tanishme*

###### a) Zhvillime pozitive

121. Komiteti këshillues vëren se janë në progres diskutimet për miratimin e mundshëm të një ligji për përdorimin e gjuhës. Gjithashtu, vëren se mendimet janë të ndryshme sa i përket kësaj çështje, varësisht si interpretohet Marrëveshja e Ohrit, sipas disave një ligj i tillë është i nevojshëm pasi kërkohet nga Marrëveshja, përderisa të tjerë mendojnë se Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi përshatshëm mbulojnë kërkesat që dalin nga Marrëveshja sa u përket gjuhëve. Duke i dhënë rëndësinë e veçantë çështjes së gjuhës në "ish Republikën jugosllave të Maqedonisë", Komiteti këshillues mendon se me miratimin e një ligji gjithëpërfshirës për gjuhën vendi do të do të vendoset në baza të qarta dhe koherente ligjore në këtë fushë, kjo do të sjell deri te zgjedhja e vështirësive të raportuara deri tani.

122. Komiteti këshillues vëren se, në përputhje me nenin 7 të Kushtetutës dhe ndryshimin e Ligjit për procedurën administrative nga viti 2005, komunat ku shqipëtarët përfaqësojnë 20% të popullatës gjithnjë e më shumë përdorin shqipen përveç maqedonishtes në takimet dhe punën e këshillave lokal dhe komisioneve për marrëdhënie ndëretnike, si dhe në hartimin e dokumenteve të tyre. Sipas Ministrisë së pushtetit lokal, përdorimi i gjuhëve të minoriteteve në strukturat e administratës publike është rritur shumë (deri 16%) në Shkup. Në të vërtetë, kjo i përket vetëm gjuhës shqipe, të cilët flasin më shumë se 20% e banorëve dhe prandaj llogaritet si gjuhë zyrtare, sëbashku me maqedonishten, në katër komuna të Shkupit si dhe në vet qytetin si tërësi.

123. Sipas informatës së pranuar nga Komiteti këshillues, gjithashtu ka debat të pandërprerë për ndryshimin e Rregullores për punën e Parlamentit për të qartësuar kushtet për përdorimin e gjuhëve tjera nga maqedonishtja të cilat plotësojnë kushtet ligjore për një përdorim të tillë në sesionet plenare të Parlamentit dhe grupeve punuese.

124. Komiteti këshillues përshëndet përpjekjet e bëra në vitet e fundit për trajnimin e përkthyesve profesionist, sidomos atyre shqiptarë, që ka aftësuar rreth 100 përkthyes për këtë gjuhë të angazhohen në pjesë të ndryshme të sistemit juridik dhe shërbimit civil.

b) Çështje të diskutueshme

125. Përkundër përparimit të vërejtur në përdorimin e gjuhës shqipe në institucionet publike, përfaqësuesit e shqiptarëve theksojnë vështirësinë ose në disa raste edhe pamundësinë për të siguruar përkthim për shkak të mungesës së përkthyesve të kualifikuar ose ndonjëherë mungesës së vullnetit.

126. Sipas informatës së pranuar nga Komiteti këshillues, përdorimi i gjuhëve tjera përveç shqipes në relacionet me autoritetet administrative është shumë sporadik. Kjo kryesisht është për shkak të faktit se komunitetet tjera etnike plotësojnë përqindjen prej së paku 20% vetëm në disa vende. Kështu turqit plotësojnë 20% në pesë komuna, romët dhe serbët në një nga komunat secilët, dhe gjuhët e tyre llogariten si gjuhë e dytë zyrtare në këto komuna. Komiteti këshillues nuk ka patur mundësi të marr informatat më të fundit për përdorimin e këtyre gjuhëve në marrëdhëniet me autoritetet administrative të komunave të cilat plotësojnë kushtet e dhëna në nenin 10, paragrafi 2 i Konventës kornizë.

127. Sipas Kushtetutës dhe legjisllacionit në fuqi, autoritetet lokale, vendosin për përdorimin e gjuhëve të minoriteteve që flitet nga së paku 20% e popullatës lokale në strukturat e adiministratës publike. Ashtu si edhe në Opinionin e tij të parë, Komiteti këshillues shpreson se autoritetet kompetente do të kenë qasje fleksibile dhe pragmatike në implementimin e dispozitave statutare në lidhje me kërkesat dhe nevojat e popullatës lokale. Kjo në praktikë do të mundësojë të merren parasysh dallimet që janë treguar nga disa grupe në mes rezultateve të regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë dhe vlerësimeve të bëra për popullatën nga këto grupe.

128. Sa i përket përdorimit të gjuhëve të minoriteteve në procedurën penale, Komiteti këshillues vëren se përkundër përpjekjeve të bëra në disa vite të fundit, edhe më tutje vazhdohet të raportohen problem, pasi numri i përkthyesve të kualifikuar në shqip, gjuhën rome, turqisht dhe të tjera është i vogël krahasuar me nevojat për përkthim.

*Rekomandim*

129. Autoritetet duhet të vazhdojnë dhe zgjerojnë tajnimin dhe angazhimin e përkthyesve të kualifikuar për të implementuar në mënyrë efektive dispozitat statutare për përdorimin e gjuhëve të minoriteteve në procedurën penale si dhe në punën e qeverisjes lokale dhe qendrore dhe në marrëdhëniet me këta të fundin. Përveç kësaj, autoritetet duhe të përkrahin qasjen inkluzive në implementimin e këtyre dispozitave për personat e komuniteteve të vogla.



## Neni 11 i Konventës kornizë

### Përdorimi i gjuhës së minoriteteve për emrat personal

#### *Zbulime nga cikli i parë*

130. Në Opinionin e tij të parë, Komiteti këshillues ka vërejtur problem sa u përket dokumenteve të identifikimit, në lidhje me transliterimin e shtrembëruar fonetik të emrave turk si dhe emrave të cilët në të kaluarën janë ndryshuar me forcë. Autoriteteve u është bërë thirrje të ndërmarrin hapa për të adresuar këto probleme. Ato gjithashtu janë nxitur të sigurojnë implementim efektiv të ligjit për dokumentet e identifikimit.

#### *Gjendja e tanishme*

##### a) Zhvillime pozitive

131. Komiteti këshillues përshëndet ndryshimet e ligjit për dokumentet e identifikimit të bëra në vitin 2005 dhe 2006 me të cilat ndryshime lejohet përdorimi i gjuhëve të ndryshme nga maqedonishtja që fliten nga së paku 20% e popullatës (vetëm shqiptarët plotësojnë këtë kusht) dhe alfabetit të tyre në dokumentet e identifikimit. Për më shumë, tani në bazë të kërkesës informatat në lidhje me emrat personal mund të futen në dokumentet e identifikimit jo vetëm në gjuhën maqedonase dhe alfabetin qirilik por edhe në gjuhën dhe alfabein e minoriteteve tjera të cilët nuk plotësojnë përqindjen e përmendur më lartë.

132. Sipas informatave të dhëna nga Ministria e punëve të brendshme, kushtet teknike për implementimin efektiv të këtyre dispozitave ligjore janë plotësuar dhe se prej janarit të vitit 2007 dokumentet e identifikimit duhet lëshuar në konformitet me këto dispozita.

133. Ndryshime të ngjajshme i janë bërë edhe legjisllacionit që rregullon dokumentet për udhëtim. Në bazë të kërkesës, këto dokumente tani mund të shtypen edhe në gjuhë (dhe alfabet) të ndryshme nga maqedonishtja, dhe kjo ka të bëjë jo vetëm me shqipen por edhe me gjuhët e minoriteteve tjera etnike. Masa të ngjajshme janë paraparë edhe për lejen për vozitje dhe dokumente të tjera lidhur me planin "dokumente të reja personale".

##### b) Cështje të diskutueshme

134. Përderisa përshëndet hapat e mara legjisllative për të lejuar përdorimin e gjuhëve të minoriteteve dhe alfabetit të tyre dokumentet e identifikimit dhe dokumentet tjera personale. Komiteti këshillues vëren se implementimi real i dispozitave të reja është në fazë fillestare dhe shpreson se autoritetet do të gjejnë mjete për t'a zgjeruar këtë proces.

#### *Rekomandim*

135. Autoritetet duhet të vazhdojnë pëpjekjet e tyre në implementimin e duhur të dispozitave të reja që rregullojnë përdorimin e gjuhëve të minoriteteve në dokumentet e identifikimit dhe në disa dokumente tjera personale.

## **Përdorimi i gjuhëve të minoriteteve për emrat të vendeve lokale**

### *Zbulime nga cikli i parë*

136. Në Opinionin e tij të parë, ka vërejtur se gjuhët e minoriteteve kombëtare po përdoren rrallë për të treguar emrat e vendeve dhe shenja tjera topografike dhe nxiti autoritetet të shqyrtojnë këtë situatë.

### *Gjendja e tanishme*

#### a) Zhvillime pozitive

137. Sipas informatave të dhëna nga Ministria e punëve të brendshme, në bazë të një vendimi të fundit gjuha shqipe dhe alfabeti mund të përdoren për të treguar emrat e vendeve. Tani këto emra tregohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin qirilik si dhe në gjuhën shqipe dhe alfabetin latin, si dhe emrat shqip të transliteruar në alfabetin qirilik. Komiteti këshillues vëren se në praktikë gjuha shqipe përdoret në të vërtetë për këto emra sëbashku me gjuhën maqedonase në komunat ku flitet nga së paku 20% e popullatës dhe ku kjo gjuhë është gjuha e dytë zyrtare.

#### b) Çështje të diskutueshme

138. Komiteti këshillues vëren se Qeveria vetëm kohëve të fundit ka ndër marrë hapa për të sqaruar kushtet për përdorimin e gjuhëve të minoriteteve për emrat e vendeve sipas dispozitave kushtetuese që rregullojnë përdorimin e gjuhëve dhe legjislacionit në fuqi që rregullon vetëqeverisjen lokale. Në mungesë të informative të fundit, Komiteti shpreson se autoritetet do të sigurojnë se kur do të plotësohen kushtet e parapara në nenin 11, paragrafi 2, atëherë edhe gjuhët e komuniteteve të vogla etnike do të mund të përdoren për të treguar emrat e vendeve. Miratimi i një ligji që do të rregullojë përdorimin e gjuhës do të jap qartësimet e duhura.

### *Rekomandim*

139. Komiteti këshillues nxiti autoritetet të marrin hapa të vendosur për të siguruar se personat që u takojnë minoriteteve të ndryshme etnike mund të përdorin gjuhët e tyre për të treguar emrat e vendeve lokale siv është e parapara në nenin 11, paragrafi 3 i Konventës kornizë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **Neni 12 i Konventës kornizë**

### *Zbulime nga cikli i parë*

140. Në Opinionin e tij të parë, Komiteti këshillues nxiti autoritetet të përshpejtojnë përpjekjet e tyre për të ndihmuar dhe lehtësuar mirëkuptimin ndërkulturor dhe kontaktet në dhe jashtë shkollave. Gjithashtu autoritetet janë ftuar të bëjnë përpjekje më të mëdha për të adresuar mungesën e librave dhe mësimdhënësve të kualifikuar në gjuhët e minoriteteve.

### *Gjendja e tanishme*

#### a) Zhvillime pozitive

141. Komiteti këshillues vëren se janë bërë përpjekje në disa vite të fundit për të promovuar tolerance dhe respektin e të drejtave të njeriut dhe për të përdorur shkollat për të bashkuar pesonat që u takojnë minoriteteve të ndryshme. Sidomos përshëndet nismat e marra për këtë në komunat e prekura nga lufta. Sidoqoftë, Komiteti këshillues vrojton se nismat e këtilla janë të zhvilluara nga OJQ-të me ndihmën e organizatave ndërkombëtare dhe shpreh keqardhje që shteti nuk është i involvuar në mënyrë adekuate në këtë lloj aktiviteti (shih gjithashtu komentet për nenin 6 më lartë).

b) Cështje të diskutueshme

142. Përderisa shënohen përpjekjet e bëra për të promovuar tolerance dhe mirëkuptimin ndëretnik në shkolla, Komiteti këshillues është i brengosur që arsimit i fëmijëve nga komuniteti i shumicës dhe komunitetet e minoriteteve (sidomos ai shqiptarë) shpesh është i ndarë. Edhe pse fëmijët shkojnë në të njëjtën shkollë, ato shpesh kanë orare të ndryshme dhe spesh edhe godina të ndara. Kjo qasje, që nuk inkurajon dialogun dhe ndërveprimin, rezulton komunikim shumë të kufizuar apo aspak nuk ka komunikim mes fëmijëve, familjeve dhe mësimitdhënësve që u takojnë komuniteteve të ndryshme, kjo sidomos u përket relacioneve mes maqedonasve dhe shqiptarëve.

143. Komiteti këshillues pranon se, për shkak të nevojave të posaçme lidhur me të mësuarit në gjuhën e minoriteteve, klasa dhe shkolla të ndara mund të jenë të nevojshme në kontekst të arsimit të minoriteteve. Komiteti vërteton se ka mënyra të ndryshme për të rregulluar këto nevoja, përfshirë edhe arsimin dygjuhësor, dhe vëren se modalitete të ndryshme janë në përdorim në “ish Republikën jugosllave të Maqedonisë” (shih vërtetimet në nenin 14 të Konventës kornizë më poshtë). Megjithatë, duke i dhënë kontekst specifik “ish Republikës jugosllave të Maqedonisë”, Komiteti këshillues mendon se kjo turbullon kur ndarja bëhet e tepruar dhe është e zgjeruar në aktivitetet jashtë orëve të nxënësve dhe të rinjve të shumicës dhe minoriteteve, përfshirë aktivitetet e lira, sportive dhe kulturore.

144. Sipas përfaqësuesve të komuniteteve të vogla etnike (siç janë vllahët), historia e re dhe librat e literaturës që përdoren në shkolla prej vitit 2005 përmbajnë shumë pak informata për grupet tjera përveç atij maqedonas dhe shqiptar, dhe planet shkollore lejojnë vet mësimitdhënësit të vendosin se sa kohë apo aspak do të kushtohet kulturës dhe historisë së komuniteteve të vogla.

145. Gjithashtu, shumë kritika i janë bërë Ministrisë së arsimit pasi nuk bën mjaftueshëm për promovimin e integritit dhe dialogut mes fëmijëve të komuniteteve të ndryshme apo për plotësimin e nevojave të këtyre fëmijëve.

*Rekomandime*

146. Komiteti këshillues iu drejtohet autoriteteve të marrin hapa të vendosura për të promovuar diturinë dhe mirëkuptimin e dyanëshëm mes nxënësve, mësuesve dhe familjeve që u përaksin komuniteteve të ndryshme etnike. Librat dhe materialet tjera shkollore duhet të ju kushtojn kujdes të devotshëm kulturave dhe identiteteve të komuniteteve të ndryshme, përfshirë edhe ata që sipas numrit të tyre janë të vogla, dhe trajnimi për stafin mësimitdhënës duhet përshtatur qëllimeve të arsimit shumëkulturorë dhe ndërkulturorë.

147. Përveç kësaj, autoritetet relevante duhet të sigurojnë se aktivitetet jashtë planit shkollor dhe mënyra se si në të vërtetë shkollat organizojnë klasat e tyre promovojnë integrimin dhe pajtimin. Shteti duhet të involvohet më shumë, duke dhënë ekspertizën dhe resurset financiare të duhura, në aktivitetet e shoqërisë civile dhe nismat për të rindërtuar besimin e ndërsjellë dhe dialogun ndërkulturor.

### **Mundësi të barabarta për akses në arsim**

#### *Zbulime nga cikli i parë*

148. Në Opinionin e parë, Komiteti këshilloes nxiti autoritetet të përforcojnë kapacitetet institucionale në departamentet relevante të Ministrisë së arsimit që merren me arsimin e minoriteteve dhe të përshpejtojnë përpjekje në promovimin e mundësive të barabarta për akses në arsim për personat që iu përkasin minoriteteve në të gjithë shkallët. Autoritetet janë të ftuar gjithashtu të gjejnë mënyra për të zvogluar përqindjen e braktisjes së shkollës nga turqit dhe shqiptarët në fazën mes shkollës fillore dhe të mesme.

#### *Gjendja e tanishme*

##### a) Zhvillime pozitive

149. Sipas informative të marra nga Raporti shtetëror, autoritetet kanë bërë përpjekje në disa vite të fundit për të përforcuar departamentet relevante në Ministrinë e arsimit përgjegjëse për arsimin e minoriteteve me staf dhe ekspertizë të duhur. Komiteti këshilloes vëren se një grua përfaqësuese e komunitetit romë është emëruar udhëheqëse e këtij departamenti.

150. Përpjekje janë bërë edhe në përmirësimin e kushteve për punë në shkolla, sidomos ato që punojnë në mjedis shumëkulturor. Hapa të këtyra janë marrë për të furnizuar këto shkolla me materialet e nevojshme dhe pajisje për mësimdhënie në gjuhët e minoriteteve të cilat janë gjuhë për mësimdhënie (shqip, turqisht dhe serbisht) dhe për mësimdhënie të vllahëve dhe romëve. Vëmendje më të madhe i është kushtuar trajnimit të mësimdhënësve për këtë lloj mësimdhënie.

151. Sipas Raportit shtetëror, hapa të posaçëm janë marrë për të ndaluar gjendjen e vështirë në shkollat turke (parashikim i më shumë klasave në gjuhën turke, financimi i librave të reja dhe sidomos trajnimi i mësimdhënësve), dhe autoritetet janë besimplotë se problemet në arsimin me cilat ballafaqohet ky minoritet do të eliminohen gradualisht.

152. Ngjajshëm, përpjekje janë bërë për të përmirësuar gjendjen e shkollave me mësimdhënie në gjuhën shqipe dhe që kanë probleme për shkak të rritjes së nevojës dhe mungesës për vend dhe pajisje të përshatëshme. Shumë projekte iu janë përkushtuar krijimit të kushteve të nevojshme materiale – përfshirë edhe ndërtimin e shkollave të reja – për përmirësimin e cilësisë së arsimit nëpërmjet trajnimit të mësimdhënësve dhe zëvendësimit të materialeve të nevojshme për mësimdhënie. Sipas Raportit shtetëror, shqiptarët tani kanë një sistem arsimor që është zhvilluar gradualisht në të gjithë nivelet. Komiteti këshilloes vëren se, edhe pse tendosjet u rriten disa vjet më parë mes nxënësve dhe familjeve nga komuniteti maqedonas dhe shqiptar për shkak të

themelimit të klasave dhe shkollave në gjuhën shqipe, këto tendosje u zbutën gradualisht, në mes tjerave për shkak të nismave të pajtimit nga shoqëria civile.

153. Sipas Ligjit për arsim të lartë nga korriku i vitit 2003, aksesit i personave që u përkasin komuniteteve të ndryshme në arsimin e lartë është ndihmuar me vendosjen e sistemit të kuotës i cili garanton akses të drejtë dhe të përshtatshëm në ligjeratat e vitit të parë për studentët që u përkasin minoriteteve. Në përputhje me këtë Ligj dhe sipas Marrëveshjes së Ohrit, këto masa pozitive kanë për qëllim të reflektojnë laramaninë etnike të popullatës në tërësi në popullatën e studentëve në universitete. Statistikat zyrtare tregojnë rritje në numrin e shqiptarëve të aftë të ndjekin arsimin e lartë në gjuhën e tyre gjatë viteve të fundit. Kjo u bë e mundur sidomos në kuadër të dy universiteteve që funksionojnë paralelisht në Tetovë, Universiteti shtetëror i Tetovës (zyrtarisht i pranuar nga Qeveria në vitin 2004 pas shumë tendosjeve) dhe Universiteti i Europës juglindore i cili është i financuar privatisht (i cili siguron arsim në shqip maqedonisht dhe anglisht). Komiteti këshillues vëren se të dy institucionet ofrojnë lëndë të ngjajshme dhe të dy në mesin e prioritetëve kanë vënë promovimin e dialogut dhe ndërveprimin mes studentëve nga komunitetet e ndryshme.

#### b) Çështje të diskutueshme

154. Ndikimi i implementimit të decentralizimit në zbatimin efektiv të masave që janë dedikuar minoriteteve etnike në fushën e arsimit është burim kryesor i shqetësimit sipas përfaqësuesve të këtyre minoriteteve. Ngjajshëm, në shumë nga ankesat e autoriteteve lokale, pavarësisht përkatësisë etnike, përmendet konfuzioni në ndarjen e kompetencave dhe një çekuilibër mes nivelit të resurseve të disponueshme dhe kompetencave të reja të autoriteteve lokale për funksionimin e shkollave. Në të njëjtën kohë, probleme dhe çrregullime janë raportuar sa i përket ndërhyrjes së panevojshme të pushtetit qendror në funksionimin e shkollave, përfshirë këtu edhe angazhimin e stafit mësimdhënës dhe emrimin të drejtorëve.

155. Sipas përfaqësuesve të Ministrisë së Arsimit, punohet një strategji e re për të shpërndarë resurse sipas numrit të nxënësve në listen e shkollave; kjo do të mundësojë plotësim më efektiv të nevojave të shkollave të minoriteteve. Tani, përkundër përpjekjeve të bëra nga Ministria për të përgatitur libra të reja dhe për të përditësuar materialet mësimore të nevojshme për këtë lloj arsimit, ende është e pamundur të rriten resurset për të shtypur këto materiale dhe për të trajnuar mësimdhënësit të nevojshëm për të gjitha komunitetet (shih komentet në nenin 14 të Konventës kornizë më poshtë).

156. Komiteti këshillues vëren se këto probleme sidomos ndikojnë tek personat që u përkasin komuniteteve të vogla, të cilët mendojnë se autoritetet duhet të kushtojnë vëmendje më të madhe nevojave të tyre në arsim. Gjithashtu duket se në disa vende vajzat shqiptare ballafaqohen me vështirësi lidhje me ndjekjen e shkollimit, përqindjen e madhe të braktisjeve (në raste të shumta në moshën 11 apo 12 vjeçare) dhe si pasojë e kësaj, grata shqiptare ballafaqohen me dituri të ulët të shkrimit dhe leximit, sidomos shkrimit dhe leximit në gjuhë maqedonase. Komiteti këshillues vëren se, përderisa hapen mundësi për reagim më të përshtatshëm ndaj nevojave në arsim të komuniteteve më të mëdha, nëse sistemi i planifikuar i financimit të arsimit sipas numrit të nxënësve në shkolla nuk zbatohet në mënyrë fleksibile mund të ketë mosbarazim në aksesin e arsimit në gjuhën e minoriteteve për grupet e vogla.

*Rekomandime*

157. Sa i përket procesit të decentralizimit, autoritetet duhet të bëjnë sqarimin e nevojshëm të kompetencave të aktorëve të ndryshëm dhe marrëveshjeve praktike për transferimin e kompetencave në fushën e arsimit, me qëllim që kjo mos të ndikoj në arsimin e personave që u përkasin minoriteteve. Posaçërisht, urgjentisht duhet kushtuar vëmendje çështjes së resurseve të nevojshëm për autoritetet lokale për të plotësuar detyrat e rritura të tyre në këtë fushë dhe me ato të veprohet me në mënyrë transparente dhe në bazë të rregullave të qarta, objektive dhe të drejta.

158. Më tutje, Komiteti këshillues inkurajon autoritetet të kenë qasje të balancuar në zhvillimin dhe implementimin e politikës së tyre për arsimin e personave që u përkasin minoriteteve në mënyrë që të sigurohet se vëmendje e nevojshme iu kushtohet nevojave të minoriteteve më të vogla.

**Gjendja e romëve***Zbulime nga cikli i parë*

159. Në Opinionin e parë, Komiteti këshillues nxiti autoritetet për të adresuar ndjekjen e ulët të shkollës dhe përqindjen e lartë të braktisjeve nga shkolla të fëmijëve romë dhe të gjejnë mënyra për përmirësimin e aksesit të romëve në arsimin e lartë, siç është kontrollimi i funksionimit të sistemit të vendosur të kuotës.

*Gjendja e tanishme*

## a) Zhvillime positive

160. Komiteti këshillues vëren me kënaqësi se Shteti ka treguar vendoshmëri më të madhe gjatë viteve të fundit në përmirësimin e gjendjes së romëve në arsim, që është prioritet në strategjinë nacionale për romët dhe në planin nacional për veprim të miratuar nga Qeveria në vitin 2005.

161. Përveç masave të posaçme për përmirësimin e gjendjes ekonomike të kësaj popullate, ka patur edhe shumë nisma për të vetëdijësuar autoritetet, familjet dhe anëtarët e sistemit arsimor për vështirësitë e vaçanta me të cilat ballafaqohen romët, sidomos vajzat romë në fushën e arsimit dhe për nevojat e tyre në këtë sektor. Sidomos, Ministria e arsimit në mënyrë progresive kërkon të kufizojë numrin e romëve që braktisin shkollimin duke marrë hapa për t'u mbrojtur nga kjo dukuri, dhe duke hartuar një strategji që do të siguroj se asnjë fëmijë nuk do të ngel jashtë sistemit arsimor. Gjithashtu është prezantuar edhe një vit i arsimit para shkollor, një ndër qëllimet e të cilit është të përgaditë fëmijët romë për të filluar në shkollë.

162. Aranzhime të veçanta, përfshirë edhe ndihma financiare nga shteti, kanë filluar për të inkurajuar dhe lehtësuar aksesin e romëve në shkollat e mesme dhe me ndihmë financiare ndëkombëtare janë zhvilluar programe për t'u dhënë përkrahje individuale dhe ndihmë nxënësve romë në arsimin e mesëm. Rezultatet fillestare janë premtuese dhe tregojnë se interesi i romëve për të vazhduar shkollimin pas shkollës fillore po rritet gradualisht.

163. Komiteti këshillues përshëndet nismat e organizatave joqeveritare të cilat janë për lavdatë dhe orvaten të vetëdijsojnë familjet për rëndësinë e arsimit për fëmijët e tyre dhe të rrisin vetëdijen e edukatorëve me qëllim të trajnimit të tyre sidomos për punën me fëmijët romë. Sidoqoft, Komiteti vëren se këto nisma janë shumë të varura nga financimi i kontributeve ndërkombëtare dhe nuk mundën të vazhdoen çdoherë poqese shteti nuk kontribun me resurse të përshtatshme.

b) Çështje të diskutueshme

Përderisa përshëndeten masat e përmendura më lartë, Komiteti këshillues vërejt se fëmijët romë ende ballafaqohen me probleme serioze në fushën e edukimit. Ndjekja e shkollës nga ana e tyre është në shkallë shumë të ulët dhe përqindja e braktisjeve nga shkolla mbetet shumë e madhe, me vetëm një përqindje të vogël të aftë të vazhdojnë shkollimin e mesëm. Kështu, sipas të dhënave zyrtare prej vitit 2005, nga gjithësej 8000 fëmijë romë të regjistruar në shkollën fillore, më pak se 700 kanë mbaruar arsimin fillorë. Sipas burimeve të ndryshme tregojnë se braktisja nga shkolla e vajzave është më shumë se 50%.

165. Pasiguria ekonomike e familjeve romë është kryesisht rrënja e këtij problemi dhe kërkon masa të vendosura nga ana e Qeverisë. Arsimi para shkollor nuk është pa pagesë, që do të thotë se edhe më shumë është vështirësuar aksesin e fëmijëve romë në përgatitjen për shkollën fillore. Fakti që shumica e këtyre fëmijëve kanë njohuri të dobëta të maqedonishtes është pengesë plotësuese që kërkon veprim të përshtatshëm nga ana e Qeverisë. Komiteti këshillues është i kënaqur të dëgjoj se tani zhvillohen programe hyrëse për të lehtësuar mbarimin e arsimit para shkollor të këtyre fëmijëve.

166. Sipër gjendjes shumë të vështirë socio ekonomike të familjeve të tyre dhe përkundër disa përmirësimeve të gjendjes në vitet e fundit, nxënësit romë shpesh ballafaqohen me sjellje armiqësore edhe nga ana e mësuesve, prindërit dhe nxënësit tjerë, si dhe me praktika të diskriminimit dhe në disa raste edhe me ndarje.

167. Komiteti këshillues vëren se masat për përkrahje financiare të dhëna (së bashku me ndihmën plotësuese ndërkombëtare) për të lehtësuar aksesin e romëve në arsimin e mesëm dhe të lartë janë shumë të dobishme dhe kanë filluar të japin fryte. Sidoqoft, Komiteti deshiron të theksoj se këto masa mund të kenë ndikim të madh poqese shteti vendosmërisht përkushtohet në garantimin e kontinuitetit të tyre dhe në sigurimin e përputhshmërisë mes furnizimeve dhe kërkesave që duket se rritet disa vite të fundit. Gjithashtu duket se mangësi janë vërejtur edhe në implementimin e sistemit të kuotës për aksesin në arsimin e lartë të romëve.

*Rekomandime*

168. Komiteti këshillues nxit autoritetet të tregojnë vendoshmëri në vazhdimin dhe zhvillimin e masave të parapara në strategjin nacionale për romët që do të përkrahë ata me resurse financiare të përshatshme, me qëllim t'u garantohet romëve mundësi të barabarta për akses në arsim, qofshin ata fëmijë apo të rritur.

169. Nëpërmjet masave të përshtatshme për përkrahje dhe për ngritje të vetëdijes, autoritetet duhet ta bëjnë primare rritjen e ndjekjes së shkollës dhe zvogëlimin e përqindjes së braktisjes së shkollës nga fëmijët romë. Ato duhet vazhdimisht të vëzhgojnë gjendjen në këtë fushë dhe të ndërmarrin veprim adekuat për problemet e

vërejtura. Vëmendje të posaçme duhet kushtuar shkollimit parashkollor dhe arsimit të mesëm dhe duhet caktuar resurse adekuate për implementimin e drejtë të masave të miratuara. Paralelisht, masat e ndërmarra për të përmirësuar aksesin e romëve në arsimin e lartë duhet të ushtrohen dhe zhvillohen edhe më tutje dhe duhet vëzhguar implementimi efektiv i tyre.

170. Në të njëjtën kohë autoritetet duhet të përshpejtojnë përpjekjet për rritjen e vetëdijes në mjediset shkollore me qëllim të parandalimit dhe zhdukjes së praktikave që sjellin deri të diskriminimi dhe ndarja e nxënësve romë, dhe çdo paraqitje të praktikave të tilla duhet përgjigjur me masa adekuate.

171. Përpjekje më të vendosura duhet gjithashtu të bëhen për trajnimin e mësimitdhënësve të cilët punojn me nxënës romë, i cili trajnim do të përfshinte edhe tërheqjen e personave që i takojn komunitetit romë në profesionin e mësimitdhënies.

### **Neni 13 i Konventës kornizë**

#### **Institucione private arsimore**

##### *Zbulime nga cikli i parë*

172. Në Opinionin e parë, Komiteti këshillues vërejt se vet fakti që legjislacioni i vendit ndalon themelimin e shkollave fillore private vendon personat që u takojn minoriteteve kombëtare në situatë të pafavorshme sa i përket arsimit fillor në gjuhën e minoriteteve dhe nxiti autoritetet të rishqyrtojnë situatën në drejtim të themelimit të shkollave të tilla.

##### *Gjendja e tanishme*

###### a) Zhvillime pozitive

173. Komiteti këshillues përshëndet zhvillimet pozitive të nënvizuara në Raportin shtetëror sa i përket arsimit të mesëm Komiteti vëren se nxënësit turk tani kanë mundësinë të studiojnë në gjuhën e tyre në shkollë të mesme private në Shkup dhe Gostivarë.

###### b) Çështje të diskutueshme

174. Komiteti këshillues vëren me keqardhje se nuk është raportuar zhvillim pozitiv sa i përket mundësisë për themelimin e shkollave fillore private. Gjithashtu me sa duket në këtë fazë nuk ka plane për zhdukjen e ndalimit me ligjin ekzistues për shkollat fillore private.

##### *Rekomandim*

175. Duke u thirrë në Opinionin e parë të tij, Komiteti këshillues nxiti autoritetet të rishqyrtojnë situatën në drejtim të lejimit të arsimit fillor privat dhe kështu që të zgjerohen mundësitë për nxënësit që u takojn minoriteteve kombëtare të mësojnë në gjuhët e tyre dhe të mësohen në ato.



## Neni 14 i Konventës kornizë

### E drejta për t'a mësuar gjuhën e minoriteteve dhe kushtet për të mësuar në këtë gjuhë

#### *Zbulime nga cikli i parë*

176. Në Opinionin e parë të tij, Komiteti këshillues shënoi kërkesën e komunitetit shqiptarë dhe atij turk për të hapur klasa të reja ku do të mësohet në gjuhën e tyre dhe kërkoi nga autoritetet të ekzaminojnë nevojat e këtyre komuniteteve dhe të saktësoj kriterin për hapjen e këtyre klasave.

177. Komiteti këshillues gjithashtu gjeti mangësi në të mësuarit në dhe të gjuhës vllëhe, rome dhe serbe dhe nxiti autoritetet të japin mbështetjen e duhur në këtë drejtim.

#### *Gjendja e tanishme*

##### a) Zhvillime pozitive

178. Komiteti këshillues vëren se, sipas Kushtetutës, personat që u përkasin minoriteteve kanë të drejtën të mësojnë gjuhën e tyre dhe të mësojnë në këto gjuhë në shkollat fillore dhe të mesme. Ngjajshëm, sipas Ligjit për arsim të lartë, shteti duhet siguroj arsim të lartë në gjuhën e minoriteteve poqese kjo gjuhë flitet nga së paku 20% e popullatës. Gjuhët e komuniteteve të minoriteteve që nuk plotësojnë këtë përqindje mund të studijohen në arsimin e lartë, mvarësisht nga nevojat dhe kërkesa, përderisa janë ekzistojnë kushtet e duhura.

179. Në praktikë, për personat që i takojnë komuniteteit shqiptar, turk dhe serb mësimi në shkollat fillore dhe të mesme zhvillohet në gjuhët e tyre, përderisa vllëhet dhe romët kanë orë fakultative për të mësuar gjuhën e tyre në disa shkolla.

180. Sipas Raportit shtëror, arsimit në gjuhën shqipe dhe studjimi i kësaj gjuhe është përhapur në të gjithë nivelet e arsimit. Ekzistojnë shkolla të përziera ku mësohet edhe në shqip edhe në maqedonisht, zakonisht në klasa të ndara, si dhe në shkolla të ndara me vetëm një nga dy gjuhët si gjuhë mësimi.

181. Komiteti këshillues vëren se në disa vite të fundit kujdes më i madh është kushtuar mësimi të gjuhës maqedonase nga komunitetet e ndryshme etnike, sidomos nga ai shqiptar. Në të njejtën kohë, me kënaqësi shënon shenjat inkurajuese të interesit të rritur në studijimin egjuhës shqipe nga maqedonasit, sidomos në komunat me popullatë të përzier (githashtu shih vrojtimitet nën nenin 6 të Konventës kornizë më poshtë).

182. Autoritetet gjithashtu mundohen gradualisht të plotësojnë kërkesat e komniteteve tjera për të rritur mësimin në dhe të gjuhëve të tyre. Sipas Raportit shtëror, një klasë në gjuhën serbe është paraqitur në shkollë të mesme në Kumanovë, dhe planifikohet të hapet katedër në gjuhën serbe në nivel të universitetit. Gjithashtu, janë marrë hapa nga Departamenti për arsimin e minoriteteve për të hapur klasa të reja në gjuhën turke (në nivel parashkollor, shkolla fillore dhe të mesme), dhe në bazë të kërkesës nga komuniteti boshnjak të paraqitet mësimi edhe në gjuhën boshnjake në disa shkolla.

183. Gjithashtu, 175 libra janë miratuar për arsimin fillor në gjuhët e minoriteteve dhe të tjera po përgatiten për t'u miratuar për shkollat e mesme.

b) Cështje të diskutueshme

184. Përkundër përpjekjeve të përmendura më lartë, mundësitë e personave që u përkasin komuniteteve të vogla për të mësuar gjuhët e tyre dhe për të mësuar në këto gjuhë tani janë të limituara. Përderisa hapja e klasave të reja për të studiuar gjuhët relevante janë kërkuar siç u tha më lartë, këto këkesa ende nuk kanë përgjigje konkrete, dhe resurset e nevojshme (libra dhe mësuesë të kualifikuar) materiale dhe njerëzore ende mungojnë. Për shembull, vllahët ka disa vite që kërkojnë klasa në gjuhë vllahë në Kërçovë, pa marrur përgjigje nga autoritetet. As nuk u është dhënë premtim për hapjen e kursit në gjuhë vllahë në Fakultetin pedagogjik në Shtip deri në datën e dorëzimit të Raportit shtetëror. Nga ana e tyre, serbët kanë raportuar mbylljen e klasave dhe shkollave për çdo vit dhe nuk pranojnë justifikimin e autoriteteve se ky trend është për shkak të mungesës së interesit të familjeve. Sipas përfaqësuesve të serbëve, rrënia e kërkesës shpjegohet me mungesën e librave dhe materialeve të përshtatshme për mësim dhe mbi të gjitha për shkak se nuk garantohet vazhdimësi i këtij mësimi.

185. Sa u përket romëve, mësimi i gjuhës së tyre është mbyllur në disa shkolla në Shkup dhe Tetovë dhe përkundër përpjekjeve të fundit nga autoritetet ata vazhdojnë të vuajnë nga mungesa e stafit të kualifikuar dhe materialit të përshtatshëm mësimor.

*Rekomandime*

186. Autoritetet duhet të përshpejtojnë përpjekjet e tyre për të zgjeruar mundësitë e personave që u përkasin minoriteteve për të mësuar gjuhën e tyre dhe sipas nevojave dhe kërkesave reale të tyre, për të pranuar mësim në gjuhët e tyre, me plotësimin e kushteteve nga Konventa kornizë.

187. Masat që po zhvillohen për trajnimin e mësuesve dhe përgatitjes së materialeve mësimore duhet të finalizohen sa më shpejt të jetë e mundur, dhe kujdes të duhur duhet kushtuar nevojave të komuniteteve të vogla.

**Neni 15 i Konventës kornizë**

**Pjesëmarrja efektive e personave që u përkasin minoriteteve në punët publike**

*Zbulime nga cikli i parë*

188. Në Opinionin e tij të parë, Komiteti këshillues vërejti se konsultimet me minoritetet kombëtare janë të kufizuara dhe nxiti autoritetet të ekzaminojnë mënyrat e vënies së dialogut direkt me organizatat të cilat përfaqësojnë minoritetet e ndryshme, përfshirë edhe përshpejtimin e formimit të një Këshilli të ministrave.

189. Më tutje, autoritetet ishin të nxitur të dyfishojnë përpjekjet e tyre për të zbatuar parimin e përfaqësimit të barabartë, përfshirë këtu edhe minoritetet me numër më të vogël, në gjithë pjesët e administratës shtetërore. Kujdesi i tyre është tërhequr nga përfaqësimi i dobët apo në rastin e romëve, mungesa e përfaqësimit të personave që u përkasin minoriteteve kombëtare në sistemin gjyqësor.

190. Masa më të vendosura janë rekomanduar për përmirësimi e pjesëmarrjes së grave shqiptare dhe romë në jetën ekonomike, përfshirë edhe zhdukjen pengesave të tepërta ligjore për pjesëmarrje efektive të tyre në tregun e punës.

#### *Gjendja e tanishme*

##### a) Zhvillime pozitive

191. Marrëveshja e Ohrit dhe proçesi i implementimit të saj si dhe Kushtetuta shtetërore përmbajnë mbrojtëse sa i përket pjesëmarrjes së minoriteteve, sidomos atij shqiptar, në punët publike dhe gjithë pjesët e administratës shtetërore, në nivel qendror dhe lokal. Kujdes i veçantë kohëve të fundit është kushtuar zbatimit më efektiv të parimit për përfaqësim të barabartë, i cili është paraqitur në Marrëveshjen e Ohrit. Një strategji për përfaqësim të barabartë është miratuar dhe komision i posaçëm paralementar është vendosur për të vëzhguar proçesin.

192. Komiteti këshillues vëren progres domethënës në pjesëmarrjen politike të komuniteteve etnike, sidomos të shqiptarëve. Këta të fundit janë sidomos aktiv në jetën politike të vendit nëpërmjet partive të tyre politik, të cilat janë prezente në koalicionin qeveritar (ku ata kanë pesë ministra) dhe në opozitë.

193. Në proçesin e sjelljes së ligjeve në Parlament, përfaqësuesit e minoriteteve kombëtare kanë rregullën e shumicës së dyfishtë<sup>viii</sup> me qëllim që të dëgjohet zëri i tyre për çështje që me rëndësi për komunitetet e tyre. Komiteti këshillues vëren se nga gjithësej 122 anëtarë të Parlamentit të tanishëm, 26 janë shqiptarë, tre janë turk, dy boshnjak, dy romë dhe një vllah. Përveç kësaj, Komision parlamentar për marrëdhëniet mes komuniteteve etnike është përgjegjës për të ndihmuar në brengat e komuniteteve të ndryshme.

194. Në përgjithësi, pas zgjedhjeve të fundit ka patur përmirësim në përfaqësimin e grupeve të ndryshme etnike. Në nivel lokal, minoritetet kombëtare janë të përfaqësuar në këshillat lokal të shumë komunave dhe mund paraqesin interesat e tyre në komisionet për marrëdhënie ndëretnike të cilët këshillojnë këto këshilla. Komiteti këshillues përshëndet faktin që me ndihmën ndërkombëtare, kohëve të fundit janë organizuar trajnime dhe aktivitete për ngritjen e vetëdijes për të zgjuar anëtarët e këtyre komisioneve të marrin veprim dhe të japin informata popullatës së interesuar. Gjithashtu, vëren se këto aktivitete për ngritjen e vetëdijes përfshijnë të drejtat e njeriut dhe minoriteteve dhe se debatet televizive për këto çështje janë transemtuar në TV lokale në Tetovë, Kërçovë, Kumanovë dhe Shkup. Komiteti këshillues vëren se, duke marrë parasysh vështirësitë me të cilët ballafaqohet në fazën e pare të implementimit, proçesi i decentralizimit në përgjithësi ka patur ndikim pozitiv në pjesëmarrjen e minoriteteve në jetën publike.

195. Komiteti këshillues me kënaqësi vëren përparimin e arritur dhe vrojtonë se tani minoritetet e ndryshme, edhe pse me përmasa të ndryshme, janë të përfaqësuar në strukturat udhëheqëse dhe stafin e më shumë institucioneve publike (organe qeveritare, organe parlamentare, Këshillin e transmetimit, Këshillin gjyqësor, Gjykatën kushtetuese, etj.) Në fund të vitit 2006 Qeveria ishte në proçes të finalizimit të masave të reja institucionale, administrative, për vetëdijësim dhe të tjera masa për të ndihmuar angazhimin e personave nga komunitetet e ndryshme në shërbimet, sektorët dhe

institucionet publike (siç janë policia dhe gjyqësia) ku ka pasur dështime në zbatimin e përfaqësimit të barabartë të komuniteteve etnike.

196. Sa u përket romëve, në arenën politike ato janë të përfaqësuar nga disa parti politike dhe nga dy anëtarë romë në Parlament. Në nivel lokal, ka 18 këshilltar lokal romë dhe përfaqësues nga kjo popullatë janë anëtarë të komisioneve lokale për marrëdhënie ndëretnike. Gjithashtu, duhet përsëritur trajnimi i posaçëm i organizuar në disa vite të fundit për të aftësuar përfaqësuesit e tyre për të qenë më prezent në punët publike. Komiteti këshillues me kënaqësi vëren nismat e marra nga gratë rome, të cilat gjithnjë e më shumë organizohen me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së tyre në punët publike dhe kështu ndihmojnë përmirësimin e gjendjes së romëve dhe luftën kundër marginalizimit të tyre dhe përjashtimit social (në lidhje me këtë shih komentet në nenin 4 më lartë). Komiteti këshillues me kënaqësi vëren se anëtarë të komunitetit romë, të cilët janë në gjendje më të mire socio-ekonomike dhe kanë arsim të lartë, marrin pjesë aktive në jetën politike të vendit dhe në media. Ata luajnë një rol të madh, në nivel qendror dhe lokal, në përpjekjet që bëhen në përmirësimin e gjendjes së popullatës rome.

197. Në përgjithësi, Komiteti këshillues përsëritet përpjekjet nga organizatat e grave që u përkasin komuniteteve të ndryshme për pjesëmarrjen e grave, pavarësisht prejardhjes etnike, në jetën publike dhe sidomos në jetën sociale dhe ekonomike. Gjithashtu, përsëritet nismat e tyre për të ndërtuar ura mes komuniteteve të ndryshme të ndara etnikisht, si dhe intersein e tyre të veçantë për Konventën kornizë dhe mekanizmat vëzhgues të saj. Në lidhje me këtë, Komiteti këshillues vëren se ligji zgjedhor tani parasheh sistemin kuotë që ka për qëllim të ndihmojë rritjen e prezencës së gruas në Parlament dhe se ligji i tanishëm për barzai mes burrave dhe grave (miratuar në maj të vitit 2006) ka themeluar komisionet për barazi gjinore në më shumë komuna.

#### b) Çështje të diskutueshme

198. Përderisa përsëritet përparimin e vrojtuar në lidhje me pjesëmarrjen e minoriteteve, Komiteti këshillues vëren se, sipas përfaqësuesve të minoriteteve, pjesëmarrja jo çdoherë ka efektin e pritur. Kështu, në Parlament, anëtarët e Komisionit për marrëdhënie mes komuniteteve etnike mendojnë se opinionet e tyre nuk merren në konsideratë mjaftueshëm në hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit nga fushat e ndryshme që janë me interes për minoritetet kombëtare. Ata thërriten në diskutimet e fundit për ligjet e policies dhe Rregulloren për punën e Parlamentit (sidomos nga aspekti i gjuhës), në të cilët diskutime ata e kanë patur shumë vështirë që të dëgjohet zëri i tyre.

199. Komiteti këshillues gjithashtu vëren se, edhe pse komisionet për marrëdhënie ndëretnike të vendosura në nivel lokal janë operative dhe duket se punojnë mire në disa komuna, edhe më tutje duhet bërë përpjekje për të vendosur këto komisione në të gjitha komunat që kanë interes,<sup>ix</sup> dhe të bëhen më efikase.

200. Në përgjithësi, Komiteti këshillues vëren dallim domethënës mes gjendjes së shqiptarëve, të cilët zënë pozitë të dukshme në jetën publike të vendit dhe luajnë një rol të rëndësishëm në vendimmarrje, dhe komuniteteve më të vogla, të cilët kanë kapacitet më të kufizuar për të ndihmuar ruajtjen e kulturës dhe identitetit të tyre. Për këtë arsye, me

rendësi është të gjinden zgjidhje për koordinim më të mirë, në elaborimin dhe implementimin e politikave për mbrojtjen e minoriteteve, me përfaqësues të komuniteteve të ndryshme dhe në këtë mënyrë të kontribuohet në një pjesëmarrje më të mirë të komuniteteve më të vogla.

201. Komiteti këshillues vëren se, pavarësisht nismave të ndërmarra nga organizata e minoriteteve për të themeluar një këshill përfaqësues i minoriteteve kombëtare, ky propozim deri tani nuk ka përkrahjen e duhur për zbatim në praktikë.

202. Në lidhje me këtë, Komiteti këshillues vëren se, kur janë në pyetje romët, pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje është i kufizuar përkundër përparimit në përfaqësimin politik në nivel lokal dhe qendror. Në përgjithësi, Komiteti këshillues është sidomos i brengosur për përjashtimin social dhe marginalizimin e shumë personave që i përkasin këtij komuniteti. Pavarësisht përpjekjeve të bëra, gjendja e grave romë vazhdon të jetë brengosëse në më shumë sfera (pë hollësi shih vrojtimit lidhur me këtë nën nenin 4 më lartë).

203. Përveç kësaj, Komiteti këshillues është i brengosur për politizimin e tepruar të çështjeve etnike të debatuar publikisht. Sa i përket zbatimit të së drejtave të personave që u përkasin minoriteteve kombëtare, qoftë në nivel lokal apo qendror, shumica e vendimeve si duket po diktohen nga vullneti i fuqive me ndikim politi, të cilat definojnë pozitat e tyre më shumë në bazë të përkatësisë etnike, se sa në bazë të obligimeve të dorëzuara në vendimmarrësve sipas legjislacionit ekzistues. Sfidat plotësuese dalin nga procesi i decentralizimit administrativ dhe financiar edhe më tutje komplikojnë gjithë këtë, edhe pse sipas autoriteteve këto janë sfida të përkohëshme dhe do të zhduken pas fazes së parë të procesit.

204. Komiteti këshillues vëren se, pavarësisht progresit të bërë, personat që i përkasin komuniteteve të ndryshme etnike vazhdojnë të raportojnë vështirësi në përpjekjet e tyre për pjesëmarrje efektive në jetë sociale, ekonomike dhe kulturore, si dhe në vendimmarrje, në nivel lokal.

205. Komiteti këshillues është gjithashtu i brengosur për problemet e raportuara në lidhje me pjesëmarrjen efektive në jetën publike nga personat që i përkasin shumicës në komuna dhe regjione ku ato *de facto* janë pakicë. Këto persona përmendin problemet në lidhje me përfaqësimin e tyre në organet jo zgjedhore të qeverisjes lokale, qasjen e tyre në shërbimet publike lokale, dhe pjesëmarrjen e tyre në jetën sociale dhe ekonomike.

206. Komiteti këshillues konsideron se është me rëndësi që në hartimin dhe implementimin e politikave për mbrojtjen e minoriteteve, sidomos në kontekst të veçantë të "ish Republikës jugosllave të Maqedonisë", qasja e marrur duhet të bazohet në norma dhe standarde të dhëna në Kushtetutë dhe në legjislacionin ekzistues, në përputhje me Konventën kornizë dhe instrumentet tjera relevante për të drejtat e njeriut dhe në bashkëpunim të ngushtë me ata që kanë interes.

#### *Rekomandime*

207. Autoritetet janë nxitur të vazhdojnë përpjekjet e tyre për të siguruar, në përputhje me Marrëveshtjen e Ohrit, përfaqësimin e barabartë të personave që u përkasin minoriteteve kombëtare në jetën publike, në nivel lokal dhe qendror, dhe me konsideratë të duhur ndaj nevojave të komuniteteve më të vogla në këtë fushë. Sidomos, komisionet

për marrëdhënie ndëretnike duhet vendosur në gjithë komunat me interes. Duhet të ekzaminohen mënyrat e përmirësimit të dialogut mes autoriteteve dhe komuniteteve të ndryshme.

208. Masa specifike duhet identifikuar për të luftuar marginalizimin dhe përjashtimin social të romëve dhe të ndihmohet pjesëmarrja më efektive e tyre në punët publike.

209. Komiteti këshillues gjithashtu nxit autoritetet të japin mbështetje të fortë aktiviteteve të organizatave joqeveritare të themeluara nga gratë të cilat u përkasin komuniteteve të ndryshme në përpjekjet e tyre për përmirësimin e pjesëmarrjes së grave në jetën publike.

## **Neni 16 i Konventës kornizë**

### **Ndarja e re teritoriale dhe përbërja etnike e njësive teritoriale**

#### *Zbulime nga cikli i parë*

210. Në Opinionin e tij të parë, Komiteti këshillues mori shënime të brengave të shprehura nga personat që u përkasin minoriteteve kombëtare për ndikimin e mundshëm negativ të draft Ligjit për kufijtë komunale në baraspeshën etnike të njësive teritoriale. Më tutje, autoritetet ishin të inkurajuara të konsultohen me personat që u takojnë minoriteteve gjatë procesit legjislativ dhe të kushtojnë kujdesin e duhur brengave të tyre.

#### *Gjendja e tanishme*

##### a) Zhvillime pozitive

211. Komiteti këshillues mer shënime për miratimin dhe hyrjen në fuqi në vitin 2004 të Ligjit për organizimin teritorial të komunave, i cili ka bërë ndryshime në proporcionin e komuniteteve etnike në komuna. Përderisa në disa raste këto ndryshime kanë shkaktuar tendosje, këto tendosje kanë rënë pa incidente të mëdha. Përkundër raporteve për çrregullime dhe tentimeve për frikësime, zgjedhjet lokale në vitin 2005 janë mbajtur në kushte relativisht të qeta dhe sipas vëzhguesve ndërkombëtarë konsiderohen të jenë në përputhje me normat ndërkombëtare.

## **Neni 18 i Konventës kornizë**

### **Bashkëpunimi bilateral në fushën e mbrojtjes së minoriteteve kombëtare**

#### *Zbulime nga cikli i parë*

212. Në Opinionin e tij të parë, Komiteti këshillues vërejtë se “ish Republika jugosllave e Maqedonisë” ka lidhur marrëveshje bilaterale për bashkëpunim në sferën kulturore me disa shtete dhe ka nxitur autoritetet të marrin parasysh nënshkrimin e marrëveshjeve të ngjajshme me çdo vend fqinjë me të cilat ende nuk janë bërë marrëveshje të tilla.

#### *Gjendja e tanishme*

##### Zhvillime pozitive

213. Komiteti këshillues vëren se Qeveria ndihmon dhe kushton kujdes të veçantë bashkëpunimit të pakufizuar mes komunave vendase dhe njësive administrative lokale të vendeve tjera, përfshirë bashkëpunimin për çështje me interes të përbashkët në lidhje me mbrojtjen e personave që u përkasin minoriteteve. Në këtë drejtim, vëren se është në përgatitje një ligj që rregullon një bashkëpunim të tillë dhe se autoritetet janë duke marrë parasysh mundësinë e nënshkrimit të Konventën kornizë të Këshillit të Europës për bashkëpunim jashtëkufitar.

214. Komiteti këshillues vëren se ka bisedime të sukseshme bilaterale mes “ish Republikës jugosllave të Maqedonisë” dhe Kroacisë, që kanë për qëllim miratimin e një marrëveshje bilaterale për mbrojtjen e minoritetit kroat dhe maqedonas në të dy vendet.

#### *Rekomandim*

215. Autoritetet janë të nxitur të mbajnë qasjen e tyre për inkurajimin dhe ndihmën e bashkëpunimitmeskufitar në interes të personave që u përkasin minoriteteve kombëtare. Ato duhet të vazhdojnë dhe zhvillojnë nismat e marra në lidhje me mbrojtjen e minoriteteve në kontekst të bashkëpunimit bilateral dhe të përforcojnë bashkëpunimin në këtë fushë me të gjitha vendet fqinje.

### III. VËREJTJE PËRFUNDIMTARE

216. Komiteti këshillues konsideron se vërejtjet e tanishme përfundimtare mund të shërbejnë si baza për konkluzionet dhe rekomandimet që do të miratohen nga Komiteti i ministrave për “Ish Republikën jugosllave të Maqedonisë”.

#### Zhvillime pozitive

217. “Ish Republika jugosllave e Maqedonisë” ka vazhduar të miratoj masa të lavdërueshme për implementimin e Konventës kornizë. Nisma të rëndësishme normative dhe praktike janë ndërmarrë për të rritur përdorimin e gjuhëve të komuniteteve etnike nga dhe në autoritetet publike dhe në diskutim e sipër është miratimi i mundshëm i një ligj gjithëpërfshirës për gjuhën.

218. Masa për ngritjen e vetëdijes dhe masa të tjera janë ndërmarrë për të ndihmuar luftën kundër diskriminimit, përfshirë edhe miratimin e një ligji për mundësitë e barabarta mes grave dhe burrave, prej të cilit duhet të kenë dobi edhe personat që u përkasin komuniteteve etnike.

219. Përpjekje të mëtutjeshme janë bërë për të ndihmuar qasjen e personave që u përkasin komuniteteve etnike në media publike dhe për të lehtësuar krijimin e mediave të tyre.

220. Ekzistojnë mundësi të zmadhuara për arsimin në dhe të gjuhës shqipe dhe nisma janë marrë për të përforcuar arsimin e minoriteteve turke, serbe dhe boshnjake.

221. Autoritetet kanë zhvilluar dhe implementuar një sër projektsh për të adresuar problemet me të cilët ballafaqohen romët në qasjen e tyre në punësim, arsim, banim, shëndetësi dhe benefite sociale.

222. Pjesëmarrja e pesronave që u përkasin komuniteteve etnike në jetën publike, dhe sidomos e shqiptarëve është rritur gradualisht, përfshirë këtu edhe vendosjen e komisioneve për marrëdhënie ndëretnike në nivel lokal. Implementimi i parimit të përfaqësimit të barabartë të komuniteteve etnike në institucionet publike është në një fazë përparimtare.

#### Çështje brengosëse

223. Përkundër nismave të marra për përmirësimin e tolerances dhe mirëkuptimit të ndësjelltë, dialogu ndëretnik mbetet i pamjaftueshëm dhe në disa raste bile virtualisht mungon, kjo është një çështje veçanërisht shqetësuese pasi prek edhe fëmijët në shkolla dhe mësuesit që u përkasin dy komuniteteve më të mëdha. Me rëndësi është autoritetet të marrin pjesë aktive dhe të mbështesin përpjekjet e bëra nga aktorët e shoqërisë civile dhe partnered ndërkombëtarë në procesin e promovimit dhe ruajtjes së klimës paqësore sociale.



224. Dialog i kufizuar ndërkulturor gjithashtu është raportuar në sferën e medias, dhe mbulimi i minoriteteve nga mediat mbetet i papërshtatshëm. Qasja e komuniteteve më të vogla në mediat publike dhe private në nivel lokal mbetet e kufizuar.

225. Garanca plotësuese antidiskriminuese janë të nevojshme dhe nuk ka legjislacion gjithëpërfshirës për luftën kundër diskriminimit. Raste të diskriminimit janë raportuar sidomos ndaj romëve, por gjithashtu ndaj personave që u përkasin minoriteteve tjera kombëtare, përfshirë shqiptarët dhe turqit.

226. Romët vazhdojnë edhe më tutje të ballafaqohen me vështirësi në qasjen e tyre në punësim, benefite sociale, kujdes shëndetësor, dokumente personale, banim dhe arsim. Nxënësit romë shpesh ballafaqohen me sjellje armiqësore dhe ndarje në shkolla.

227. Përpjekjet e autoriteteve për të përkrahur arsimin e minoriteteve, edhe pse janë të çmuara, nuk i plotësojnë në mënyrë të përshatshme nevojat e komuniteteve më të vogla dhe vështirësi ende raportohen në lidhje me qasjen e shqiptarëve në mësimin e dhe në gjuhën e tyre. Edhe pse procesi i decentralizimit është në zhvillim, arsimi i minoriteteve është i ndikuar nga paqartësia e shpërndarjes së kompetencave dhe të resurseve. Përveç kësaj, shkolla fillore private ende nuk janë të lejuara me legjislacionin e vendit,

228. Edhe pse janë ndërmarrë hapa të rendësishëm në këtë fushë, edhe më tutje janë të nevojshme përpjekje sa i përket përdorimit të gjuhës së minoriteteve etnike në komunikimin me dhe në autoritetet publike.

229. Pjesëmarrja e personave që u përkasin komuniteteve etnike në vendimmarrje mund të jetë më efektive, edhe në nivel qendror edhe në atë lokal, sidomos për komunitetet më të vogla. Përfaqësimi i komuniteteve etnike në strukturat e zbatimit të ligjit dhe në gjyqësi mbetet i pamjaftueshëm.

230. Politizimi i çështjeve etnike dhe etnicizimi i debateve politike dhe vendimmarrjes vazhdojnë të rrezikojnë integrimin e shoqërisë.

## **Rekomandime**

231. Përveç masave që duhet të merren për implementimin e rekomandimeve të detajuara të përmbajtura në pjesën I dhe II të Opinioneve të Komitetit këshillues, autoritetet janë të ftuara të marrin edhe këto masa për përmirësimin e implementimit të mëtutjeshëm të Konventës kornizë:

- të marrin hapa plotësuese, në nivel legjislativ dhe në praktikë, për të siguruar mbrojtësa adekuat nga diskriminimi në të gjithë fushat dhe ilaçe juridike për viktimat potenciale; të intensifikojnë përpjekjet në vëzhgimin dhe luftën kundër diskriminimit të personave që u përkasin komuniteteve etnike dhe të adresojnë me masa të përshatshme vështirësitë me të cilat ballafaqohen gratë që u përkasin komuniteteve të ndryshme etnike;
- të intensifikojnë masat që kanë për qëllim promovimin e tolerances dhe respektit të shumëllojshërisë dhe të drejtave të njeriut mes autoriteteve publike, përfshirë policinë dhe gjykatat, dhe publikun në përgjithësi;

- të marrin masa efektive për të përforcuar dialogun ndëretnik dhe mirëkuptimit të ndërsjelltë, përfshirë edhe në fusha ku personat që i përkasin shumicës janë pakicë;
- Me gjithë respektin e duhur për pavarësinë redaktuese, të inkurajojnë mediat, në nivel lokal dhe qendror, të kushtojnë kujdes më të madh komuniteteve të ndryshme etnike dhe dhe të luajnë rol më efektiv në promovimin e respektit, dialogut dhe bashkëpunimit mes grupeve të ndryshme;
- Të adresojnë mangësitë në implementimin e kornizës ekzistuese ligjore që rregullon përdorimin e gjuhëve të komuniteteve etnike në komunikim me dhe në autoritetet publike, dhe të marrin hapa drejt miratimit të legjislacionit gjithëpërfshirës për gjuhën;
- Të zgjerojnë mundësitë për arsim në gjuhën e minoriteteve, përfshirë edhe komunitetet e vogla, duke marr parasysh nevojat e tyre reale dhe të përshpejtojnë përpjekjet për të adresuar problemet e ndryshme me të cilët ballafaqohen romët në fushën e arsimit;
- Të sigurojnë se në organizimi i arsimit dhe aktivitetet tjera lidhur me këtë nuk mungon ndërveprimi dhe dialogu mes fëmijëve, mësuesve dhe familjeve që u përkasin dy komuniteteve më të mëdha etnike;
- Të implementojnë masa më të vendosura për eliminimin e diskriminimit dhe pengesave për pjesëmarrjen e plotë të romëve në fusha të ndryshme, siç janë punësimi, banimi, shëndetësia dhe arsimit; të kushtojnë vëmendjen e duhur sidomos gjendjes së gruas rome;
- Të vazhdojnë më tutje implementimin e Marrëveshjes së Ohrit dhe sidomos parimit të përfaqësimit të barabartë të personave që u përkasin komuniteteve etnike në institucionet publike, dhe të rrisin efektivitetin e pjesëmarrjes së këtyre personave në strukturat këshilluese në nivel lokal dhe qendror.

---

<sup>ii</sup> Sipas regjistrimit të përgjithshëm, diku 4000 veta kanë identifikuar veten si egjiptian. Sidoqoft, sipas llogaritjeve jozyrtare, numri i tyre është më i madh

<sup>iii</sup> Shih gjithashtu Komisionin e Venedikut, Raport për të drejtat e jo shtetasve dhe minoriteteve, CDL-AD (2007)001, 18 janar i vitit 2007.

<sup>iv</sup> Shih, mes tjerash, Komiteti i Kombeve të bashkuara për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, Vlerësimin e raporteve nga Shtetet anetare nën nenin 16 dhe 17 të Marrëveshjes, Vrojtimet perfundimtare, "Ish Republika jugosllave e Maqedonisë", 24 nëntor i vitit 2006, E/C, 12/MKD.CO/1

<sup>v</sup> Sipas informatave jo zyrtare dhe atyre nga autoritetet, diku 40% e popullatës në vend janë të papunësuar

<sup>vi</sup> Sipas rezultateve nga regjistrimi fundit të përgjithshëm romët përbëjnë 2.7% të popullatës në vend

<sup>vii</sup> Sipas përfaqësuesve të Ministrisë së punës dhe politikës sociale, diku 16,000 romë janë regjistruar në bazat e të dhënave në qendrat për punësim në dhjetor të vitit 2006.

---

<sup>viii</sup> Sipas Marrëveshjes së Ohrit, janë bërë ndryshime të Koushtetutës të cilët parashohin “shumicë të dyfishtë” për të kaluar ligjet që kanë lidhje me komunitetet etnike (ligje lidhur me kulturën, arsimin, dokumentet personale dhe përdorimin e simboleve). Në fakt, kjo do të thotë se shumica e të gjithë anëtarëve të Parlamentit dhe shumica e të gjithë deputetëve që pëfaqësojnë komunitetet etnike duhet të përkrahin një ligj të tillë për t’u miratuar.

<sup>ix</sup> Në kohën e vizitës të Komitetit këshillues, komisione të tilla janë vendosur në vetëm 8 nga 21 komuna të interesuara